

B a n k a e S h q i p ë r i s ë

RAPORTI VJETOR  
I MBIKËQYRJES

2 0 0 6

*Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.*

*Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr. 1, Tiranë.*

*Tel: 355-4-222230; 235568; 235569;*

*Faks: 355-4-223558*

*e-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)*

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

*Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni:*

*Spektori i Botimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit.*

*E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)*

*Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.*

*Tirazhi: 1000 kopje*

## P Ë R M B A J T J A

Misioni i mbikëqyrjes	7
A. Mbikëqyrja gjatë vitit 2006	9
1. Ndryshimet dhe zhvillimet në kuadrin ligjor dhe rregullativ	9
2. Mbikëqyrja në vend	11
3. Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar dhe sfidat e zbatimit në sistemin bankar shqiptar	18
4. Përqendrimi dhe konkurrenca në sistemin bankar shqiptar	23
B. Gjendja financiare e sistemit bankar në vitin 2006	28
1. Mjedisi ekonomik në vitin 2006	28
2. Struktura e sistemit bankar shqiptar	31
3. Administrimi i rreziqeve në veprimtarinë bankare	41
4. Mjaftueshmëria e kapitalit	47
5. Treguesit e rentabilitetit	49
C. Institucionet financiare jobanka	54
1. Aktiviteti i institucioneve financiare jobanka në Shqipëri	54
2. Kuadri rregullativ i institucioneve financiare jobanka në Shqipëri	54
3. Mbikëqyrja e institucioneve financiare jobanka	55
Aneks 1. Struktura e Departamentit të Mbikëqyrjes (datë 31 dhjetor 2006)	57
Aneks 2. Niveli i aktiveve, i depozitave dhe i kredive në dhjetor 2006 (milionë lekë)	58
Aneks 3. Numri i degëve, i agjencive dhe i punonjësve për çdo bankë	59
Aneks 4. Aktivet dhe pasivet e sistemit bankar (dhjetor 2006)	60
Aneks 5. Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë	62
Aneks 6. Lista e rregulloreve dhe e udhëzimeve të Mbikëqyrjes Bankare në fuqi, deri në mars 2007	83

## P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

Tabelë 1.	Indeksi HHI për sistemin bankar shqiptar, 1999 – 2006.	24
Tabelë 2.	Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave, në fund të vitit 2006.	32
Tabelë 3.	Numri i subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas viteve.	34
Tabelë 4.	Ecuria e numrit të punonjësve të sistemit bankar në vite.	36
Tabelë 5.	Shpërndarja gjeografike e degëve dhe agjencive bankare, në fund të vitit 2006.	36
Tabelë 6.	Indeksi H (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë.	39
Tabelë 7.	Struktura e tepricës së kredisë sipas afatit, në përqindje.	43
Tabelë 8.	Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave (në përqindje).	43
Tabelë 9.	Klasifikimi i kredisë në përqindje ndaj tepricës së kredisë.	44
Tabelë 10.	Ecuria e raportit të aktiveve afatshkurtra ndaj pasiveve afatshkurtra për sistemin bankar.	45
Tabelë 11.	Struktura e kapitalit aksioner të sistemit dhe ecuria e komponentëve të tij në vite.	47
Tabelë 12.	Ecuria e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut të sistemit bankar në vite.	48
Tabelë 13.	Ecuria e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave.	49
Tabelë 14.	Ecuria e elementeve kryesore të rezultatit neto (jo kumulative) në milionë lekë.	50
Tabelë 15.	Tregues kryesorë të rentabilitetit në përqindje.	51
Tabelë 16.	Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore në përqindje.	52
Tabelë 17.	Tregues të rentabilitetit në milionë lekë.	53
Tabelë 18.	Treguesi i efikasitetit (jo kumulative) në milionë lekë.	53
	1. Struktura e aktiveve	55
	2. Cilësia e aktiveve	55

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

Grafik 1.	Krahasimi me vendet e BE-së i indeksit HHI të aktiveve të sistemit bankar.	24
Grafik 2.	Indeksi HHI i aktiveve, për Shqipërinë dhe vende të tjera të SEE.	24
Grafik 3.	Statistika H për sistemet bankare të Shqipërisë dhe disa vendeve të CEE dhe SEE.	26
Grafik 4.	Statistika H për sistemet bankare në Shqipëri dhe në vende të zhvilluara.	26
Grafik 5.	Struktura e pronësisë së kapitalit të sistemit bankar, në vite.	35
Grafik 6.	Struktura e pronësisë së kapitalit sipas grupbankave.	35
Grafik 7.	Numri i degëve/agjencive (në përqindje) sipas grupbankave.	35
Grafik 8.	Numri i punonjësve (në përqindje) sipas grupbankave në vite.	36
Grafik 9.	Peshat e grupbankave në sistem sipas totalit të aktiveve.	40
Grafik 10.	Struktura e aktiveve.	41
Grafik 11.	Struktura e pasiveve.	41
Grafik 12.	Teprica bruto e kredisë (në miliardë lekë).	42
Grafik 13.	Kredia e re e akorduar nga sistemi bankar, mbi bazat tremujore (në miliardë lekë).	42
Grafik 14.	Peshat e grupbankave në totalin e tepricës së kredisë së sistemit bankar.	42
Grafik 15.	Vëllimi i tepricës së kredisë sipas sektorëve (në miliardë lekë).	42
Grafik 16.	Përbërja e aktiveve likuide (dhjetor 2006).	45



## MISIONI I MBIKËQYRJES

Mbikëqyrja ushtrohet nga Banka e Shqipërisë, si bankë qendrore, në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” nr. 8269, datë 23.12.1997 dhe të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” nr. 8365, datë 02.07.1998.

### MISIONI I MBIKËQYRJES

Banka e Shqipërisë, në zbatim të përgjegjësive ligjore si autoriteti mbikëqyrës i bankave dhe i subjekteve të tjera, që kryejnë veprimtari financiare të licencuara prej saj, ka për qëllim që:

- të sigurojë veprimtari të shëndoshë bankare në harmoni të plotë me / dhe në zbatim të kuadrit ligjor e rregullativ përkatës, me qëllim parandalimin e krizave financiare dhe mbrojtjen e depozituesve;
- të ruajë stabilitetin e sistemit bankar dhe më gjerë, duke monitoruar zhvillimet e tregut dhe duke rekomanduar masat e nevojshme, në mënyrë që bankat t’iu përshtaten këtyre zhvillimeve dhe të administrohen në vazhdimësi sipas parimeve më të mira;
- të forcojë besimin e publikut tek sistemi bankar si edhe të nxisë disiplinën e tregut, duke kërkuar rritjen e transparencës së sistemit bankar;
- të ndikojë në zhvillimin e një konkurrence të ndershme në sistemin bankar dhe më gjerë, dhe të sigurojë trajtimin e barabartë të subjekteve të licencuara dhe të klientëve të tyre;
- të ofrojë një komunikim të vazhdueshëm profesional ndaj operatorëve të tregut financiar si edhe ndaj institucioneve të tjera që ndikojnë në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, në kuadër të përmirësimit të funksionimit të tregut financiar dhe të operatorëve të tij.

Banka e Shqipërisë, do të realizojë funksionin e saj mbikëqyrës, nëpërmjet:

- a) ndërtimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës, në mënyrë që ai të jetë në harmoni me parimet më të mira ndërkombëtare dhe i zbatueshëm në praktikë;
- b) inspektimeve në vend dhe analizës së treguesve të institucioneve të licencuara, si edhe marrjes së veprimeve korrektuese për zgjidhjen e

- problemeve të ndryshme;
- c) orientimit të procesit mbikëqyrës drejt identifikimit të rrezikut me të cilin ndeshen institucionet e licencuara, duke rekomanduar zgjidhjet përkatëse;
  - d) ndërtimit të politikave, të cilat synojnë orientimin e sistemit bankar drejt zhvillimeve të dëshiruara;
  - e) bashkëpunimit me institucionet financiare që mbikëqyren, me institucione të tjera financiare brenda vendit si edhe me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera;
  - f) përmirësimit të vazhdueshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse.

Në zbatimin e kërkesave të funksionit mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë do të synojë nivelet më të larta të integritetit, të profesionalizmit, të eficiencës dhe të transparencës.



## A. MBIKËQYRJA GJATË VITIT 2006

### 1. NDRYSHIMET DHE ZHVILLIMET NË KUADRIN LIGJOR DHE RREGULLATIV

Viti 2006 njohu zhvillime të kuadrit ligjor dhe rregullativ të mbikëqyrjes së veprimtarisë bankare dhe financiare të bankave të sistemit. Kjo gjeti mishërim në ligjin e ri “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, që rregullon veprimtarinë e bankave dhe degëve të bankave të huaja, që veprojnë në vend dhe në ndryshimet e disa rregulloreve e hartimin e të rejave. Në bazën e këtyre zhvillimeve të rëndësishme do të ishin praktikat dhe eksperiencat më të mira evropiane, dhe rekomandimet e standardet e Komitetit të Bazelit për mbikëqyrjen bankare, parimet bazë për një mbikëqyrje efektive si dhe zhvillimet në sektorin bankar në vend.

Ligji i ri, parasheh kërkesa më të forta në licencimin e bankave dhe të degëve të bankave të huaja, për transparencën e bankave me publikun dhe me pjesëmarrësit e tregut mbi profilin e rrezikut të tyre, një filtër më të hollë dhe më përfshirës në kërkesat për personelin drejtues të bankave, koncepte të reja për mbikëqyrjen e konsoliduar, procedura më të qarta për procesin e kujdestarisë dhe të likuidimit, kërkesa të reja për ekspertët kontabël të autorizuar, kërkesa më të diferencuara të nevojave për kapital etj..

Ligji dhe tërësia e ndryshimeve në aktet rregullative mbikëqyrëse, synojnë në vazhdimësi përmbushjen e objektivit për sigurimin e stabilitetit financiar.

#### a. Akte rregullative të reja:

Me vendimin nr. 32, datë 03.05.2006 u miratua rregullorja “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e disa kritereve bazë, të cilat duhen zbatuar nga subjektet e saj me qëllim minimizimin e rrezikut, që mund të vijë nga papërshtatshmëria ose keqfunksionimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Këto kërkesa parashihen të jenë fleksibël, për vetë nivelin e zhvillimit dhe ndryshimit shumë të shpejtë në këtë fushë. Sot, teknologjia e informacionit dhe komunikimit, si një instrument i rëndësishëm në zgjerimin e veprimtarisë së institucioneve financiare, konsideron edhe një nivel rreziku për këto të fundit. Standardet ndërkombëtare po theksojnë gjithnjë e më shumë rëndësinë e zbatimit të disa

kërkesave bazë në ngritjen dhe monitorimin e këtyre sistemeve, me qëllim miradministrimin e rrezikut operacional që rrjedh prej tyre.

b. Ndryshimet përfshijnë këto rregullore:

- 1- Me vendimin nr.68, datë 13.09.2006 u miratua ndryshimi në rregulloren "Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre". Ky ndryshim lidhet me saktësimin e një prej elementeve të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit - "tepricës së portofolit të kredive". Në rregulloren e mëparshme, përdorej elementi "tepricë bruto e portofolit të kredive", ndërsa ndryshimi konsideron "tepricën neto të portofolit të kredive pas zbritjes së provigjoneve". Nga ana sasiore, ndryshimi konsideron zbritjen e provigjoneve si nga emëruesi ashtu dhe nga numëruesi i raportit, domethënë bën të mundur saktësimin në llogaritjen e tij si raport i dy elementeve me bazë të krahasueshme (bazë neto); ndërsa nga ana cilësore, pa ndryshuar madhësinë e raportit të parashikuar në rregullore, e transformon këtë të fundit nga një normë mbikëqyrëse shumë e matur, në një normë mbikëqyrëse në dinamikë me veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre.
- 2- Me vendimin nr.69, datë 13.09.2006 u miratua heqja e një kufizimi në kërkesat për anëtarët e komitetit të kontrollit të bankës, të parashikuara në rregulloren "Për administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja". Anëtarë të këtij komiteti mund të jenë edhe anëtarët e këshillit drejtues, të cilët plotësojnë të gjitha kërkesat lidhur me kualifikimin, të parashikuara në këtë rregullore. Rasti shqiptar ka njohur deri më sot kufizimin që vetëm 2/3 e anëtarëve të komitetit të kontrollit të bankës, mund të jenë dhe anëtarë të këshillit drejtues. Ndërkohë, ndryshimi i propozuar mundëson praninë tërësore, në rastet që paraqiten, edhe të anëtarëve të këshillit, pa cënuar pavarësinë e komitetit, si dhe rregullon mungesat e anëtarëve të këtij komiteti, që në disa banka paraqitet i paplotësuar me numrin e kërkuar të anëtarëve.
- 3- Me vendimin nr.70, datë 13.09.2006 u miratua një shtesë në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës". Kjo shtesë synon vërtetësinë e burimeve financiare të individëve aksionerë të bankës në rastet e një detyrimi të varur, në shtojcë kjo të kërkesave të njëjta që i referohen burimeve të kapitalit. Deri më sot kontributi i aksionerëve në kapital, në formën e detyrimeve të varura, njihet vetëm në disa banka private me kapital të huaj dhe në këto të fundit jo nga aksionerë individë. Shfaqja e këtij elementi, në bankat private me kapital shqiptar bëhet së fundi e dukshme dhe u bë shtysë në rishikimin e këtij udhëzimi. Shtesa në udhëzim krijon mundësinë e transparencës për burimet e individëve, në rastet kur ata si aksionerë, kontribuojnë në formën e detyrimeve të varura, në burimet e përhershme të bankës.
- 4- Me vendimin nr.101, datë 27.12.2006 u miratuan disa ndryshime të rëndësishme në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë". Këto ndryshime, synojnë administrimin më të mirë nga sistemi bankar të zhvillimeve në fushën e kredisë dhe ruajtjen e cilësisë së

saj. Ndryshimet kryesore përfshijnë saktësime lidhur me nevojën e përmirësimit të sistemeve të analizës së bankave për portofolet e kredisë sipas karakteristikave të tyre, me qëllim monitorimin në kohë reale të zhvillimeve të këtyre portofoleve; kërkesa të reja lidhur (a) me transparencën e bankave me klientët e tyre kredimarrës të motivuara nga praktika, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga njëra anë dhe të bankës nga ana tjetër, për shembull ndaj ndonjë rreziku ligjor, si edhe për të përmirësuar mënyrën e zhvillimit të konkurrencës në tregun bankar; dhe (b) me veprimet që duhet të ndërmerren strukturat drejtuese të bankës, me qëllim që të administrojnë më mirë rrezikun e kredisë dhe të ruajnë cilësinë e portofolit të saj. Kërkesat janë të tilla që sigurojnë në të njëjtën kohë, fleksibilitetin e duhur në zhvillimin e veprimtarisë, si edhe ofrojnë elementet e nevojshme për një vendimmarrje të shpejtë në drejtim të ruajtjes së cilësisë së kredisë; plotësime lidhur me përcaktime (i) të elementit – garanci në procesin e kredimarrjes, me qëllim mirësigurimin e kredisë; dhe (ii) përcaktime të ruajtjes së klasifikimit të kredisë, me qëllim kryerjen e këtij procesi në mënyrë të dokumentuar dhe të kujdesshme.

- 5- Me vendimin nr.80, datë 25.10.2006 u miratua një shtesë në rregulloren “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”. Kjo shtesë lidhet me përcaktimin e kushteve për miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë, në rastin e transferimit të drejtës së pronësisë të aksionerëve indirektë, në masën mbi 10 për qind ose më shumë të kapitalit të bankës ose të aksioneve të saj me të drejta vote, ose në një masë të tillë që krijon mundësi të ndikojë në drejtimin a politikatat e saj, – si rast i paparashikuar nga rregullorja ekzistuese dhe jo i ndeshur në praktikë. Në rastin e ndryshimit të aksionerit indirekt, sikurse parashikohet edhe në rastin ndryshimit të aksionerit direkt, banka është e detyruar të kërkojë miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë dhe të plotësojë dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore.

## 2. MBIKËQYRJA NË VEND

Gjatë vitit 2006, Banka e Shqipërisë ka vazhduar politikën e mbikëqyrjes së subjekteve të licencuara prej saj sipas karakteristikave të rrezikut. Banka e Shqipërisë ka arritur të sigurojë stabilitetin e sistemit bankar, duke përmbushur kështu një prej përgjegjësive të saja ligjore, nëpërmjet mbikëqyrjes së vazhdueshme nga jashtë dhe inspektimeve në vend, duke evidentuar problemet dhe marrë masat e duhura për përmirësimin e tyre.

I orientuar drejt rreziqeve, procesi mbikëqyrës në vitin 2006 ka pësuar përmirësime të vazhdueshme, duke përfshirë në listën e rreziqeve edhe ato operacionale, si në drejtim të identifikimit ashtu edhe të sensibilizimit të drejtuesve të subjekteve të licencuara, për monitorimin dhe minimizimin e tyre. Gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme një vëmendje e veçantë i është kushtuar bankave dhe subjekteve jobanka, me profil më të lartë rreziku, duke iu bërë një analizë më të detajuar veprimtarive me rrezik më të lartë.

Edhe gjatë vitit 2006 ka vazhduar tendenca në rritje e portofolit të kredive, duke kërkuar një ndjekje me përparësi të ecurisë së tij dhe të realizimit të rekomandimeve, lidhur me cilësinë e këtij portofoli. Nga ekzaminimet në vend është kërkuar përmirësimi i punës së bankave, në drejtim të analizës së treguesve ekonomiko-financiarë të veprimtarisë së klientëve kredimarrës si dhe të ndjekjes në vazhdimësi të ecurisë së kthimit të kredive, duke rritur dhe monitorimin në vend të aktivitetit të këtyre klientëve. Procesi i blerjes së kredive të mëdha (shpesh herë dhe problematike) nga njëra bankë në tjetrën, ka kërkuar rritjen e numrit të inspektimeve në vend, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të tyre. Për mënyrën e këtyre problemeve janë lënë rekomandime lidhur me rritjen e rolit dhe të efektivitetit të punës së organeve drejtuese dhe kontrolluese të bankave. Kështu, mbikëqyrja bankare e drejtuar nga motoja “parandalim i sëmundjes se sa kurim i saj”, ka marrë masa të menjëhershme për parandalimin e rreziqeve në bankat që kanë patur probleme në procesin kredidhënës.

Tregues të rëndësishëm, të ndjekur me kujdes nga Banka e Shqipërisë, kanë qenë ndërmjet të tjerëve cilësia e portofolit të kredisë dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, të cilët japin sinjale të rëndësishme për problemet që shfaqin bankat.

Komunikimit me strukturat përfaqësuese të bankave, i është kushtuar një vëmendje e posaçme, edhe gjatë vitit 2006. Janë realizuar takime me përfaqësues të strukturave më të larta drejtuese të bankave, në të cilat është diskutuar për situatën e sistemit bankar në përgjithësi si edhe të bankës në veçanti, duke paraqitur shqetësimet mbikëqyrëse dhe duke kërkuar angazhimin e organeve drejtuese të bankës, për zgjidhjen e tyre.

Gjatë vitit 2006 dhe në vazhdim, një vëmendje e posaçme i është kushtuar bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve prej të cilave origjinojnë investimet e huaja në sistemin bankar shqiptar.

Bashkëpunimi me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në Austri është konkretizuar gjatë vitit 2006. Kështu, në muajin mars 2006, përfaqësues të këtij autoriteti morën pjesë në inspektimin e plotë të Bankës Raiffeisen, në Shqipëri. Më pas, në muajin maj, drejtuesi më i lartë i këtij institucioni, kreu një vizitë zyrtare në Bankën e Shqipërisë, ku u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit si dhe mbi situatën e Bankës Raiffeisen. Kjo vizitë u pasua nga ajo e drejtuesve të Departamentit të Mbikëqyrjes pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Austri, gjatë së cilës u zhvilluan bisedime tripalëshe midis përfaqësuesve të Bankës së Shqipërisë, të Autoritetit Mbikëqyrës të Tregut Financiar të Austrisë, të Raiffeisen International dhe të Raiffeisen-Shqipëri.

Është forcuar bashkëpunimi me Bankën e Greqisë, ku përmendim që në vijim të vizitës së delegacionit të Bankës së Shqipërisë në Bankën e Greqisë, në vitin 2005, Guvernatori i Bankës së Greqisë dhe Drejtori i Mbikëqyrjes kryen, në prill 2006, një vizitë zyrtare në Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu një grup inspektorësh të Bankës së Greqisë, kryen inspektimin e bankës “Tirana”, të asistuar edhe nga inspektorë të Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.

Me Autoritetin e Pagesave të Kosovës, me Bankën Kombëtare të Maqedonisë dhe me Bankën Qendrore të Malit të Zi, janë shkëmbyer informacione të përgjithshme mbi përbërjen dhe ecurinë e sistemit bankar. Ka vijuar bashkëpunimi dhe është shkëmbyer informacion me Bankën Kombëtare të Bullgarisë dhe me Bankën e Italisë, respektivisht në kuadër të transformimit të planifikuar të degës së Bankës së Parë të Investimeve, në bankë dhe blerjes së Bankës Italo-Shqiptare dhe Bankës Amerikane të Shqipërisë, nga San-Paolo IMI.

Në bashkëpunimin me institucionet brenda vendit, ne kemi vijuar të tregojmë vullnet të mirë, në respektim të ligjit si edhe të marrëveshjeve të nënshkruara.

Bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare dhe ato të specializuara në fushën e asistencës teknike, ka qenë i frytshëm gjatë vitit 2006. Është bashkëpunuar me ekspertët ligjorë të FMN-së për të asistuar në përgatitjet e projektligjeve “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe “Për parandalimin e pastrimit të parave”, si edhe për masat e nevojshme që duhen marrë, me qëllim ruajtjen e cilësisë së portofolit të kredisë në kushtet e rritjes relativisht të shpejtë të saj etj..

Gjatë vitit 2006 janë kryer këto inspektime:

Banka	14 inspektime të plota 14 inspektime të pjesshme
Institucione jobanka	5 inspektime të plota
Shoqëri të kursim-kreditit	2 inspektime të plota
Zyra të këmbimit valutor	54 inspektime

Në të gjitha këto ekzaminime të kryera gjatë vitit 2006, objektiv kryesor ka qenë gjendja e shëndoshë dhe e sigurtë e subjekteve të licencuara.

## 2.1 BANKAT

Zgjerimi i veprimtarisë së sistemit bankar dhe rritja e kreditimit, janë rezultat i natyrshëm i përmirësimit të eficiencës së përdorimit të burimeve financiare. Ritmi i shpejtë i këtij zgjerimi, në një mjedis konkures, ka rritur presionin ndaj bankave për të vepruar brenda standardeve të adoptuara, në drejtim të sistemeve të kontrollit dhe të monitorimit të drejtimeve kryesore të veprimtarisë. Zhvillimet e këtij viti, tregojnë se ritmi i shpejtë i investimeve të burimeve financiare në instrumente që sigurojnë një normë fitimi më të lartë, ka çuar në një ulje të mëtejshme të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe në rritjen e treguesve të kredive me probleme. Ndonëse këta tregues janë në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë ka kërkuar nga strukturat drejtuese të bankave tregtare, të hartojnë politika të

ekuilibruara dhe më realiste zhvillimi, dhe të forcojnë kapacitetet analizuese të rreziqeve të veprimtarisë. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2006 ka marrë dhe do të marrë masa, të cilat adresojnë çështjet e ngritura më sipër në afat të shkurtër. Këto masa lidhen me forcimin e inspektimeve në banka, duke synuar ruajtjen e kapitalizimit të mirë të veprimtarisë bankare në tërësi dhe ruajtjen e cilësisë së aktiveve, veçanërisht të portofolit të kredisë.

Nga ekzaminimet në vend, rezulton se sistemi bankar vazhdon të jetë i kapitalizuar mirë dhe të kreditojë në mënyrë të qëndrueshme ekonominë e vendit. Këto zhvillime pozitive pritet të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Por, ritmet e shpejta të zgjerimit të veprimtarisë së sistemit bankar, në kushtet e një mjedisi konkurses duhet të shoqërohen me një vëmendje më të madhe në drejtim të ruajtjes së cilësisë së aktiveve.

Probleme të dala nga ekzaminimet e plota.

Problemet e konstatuara nga ekzaminimet në vend mund t'i ndajmë si më poshtë:

*Probleme që lidhen me administrimin e lartë* (këshilli drejtues dhe komiteti i kontrollit). Rekomandimet e ekzaminimeve kanë synuar rritjen e përgjegjësisë së këtyre organeve, duke theksuar (probleme në vëmendje të këshillit drejtues) problemet, të cilat janë gjykuar kritike për të siguruar një aktivitet të shëndoshë dhe të sigurtë të bankave. Theksimi i këtyre rekomandimeve ka si qëllim ushtrimin nga këto organe, të kompetencave dhe përgjegjësi në plotësimin e bankave me politika dhe procedura të mjaftueshme, për një aktivitet të shëndoshë dhe të sigurtë të tyre. Një qëllim tjetër është eliminimi i paqartësisë apo i ngadalësisë të këshillave drejtues apo divizioneve të kontrollit (në bankat-mëmë), në drejtim të zgjidhjes së problemeve të bankave (filiale apo degë) që ushtrojnë aktivitetin në Shqipëri.

Është kërkuar gjithashtu, rritja e pranisë së komiteteve të kontrollit në banka, bashkëpunimi më i ngushtë i tyre me kontrollin e brendshëm, rritja e përgjegjësisë për problemet e prezantuara etj..

Një nga rekomandimet e dhëna më shpesh, lidhet me plotësimin e dokumentacionit për drejtuesit e lartë, për të cilët duhet të merret miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë. Shpesh ky dokumentacion paraqitet me shumë vonesë në Bankën e Shqipërisë. Organet drejtuese të bankave, në përgjithësi kanë reaguar pozitivisht ndaj rekomandimeve. Në funksion të rritjes së bashkëpunimit midis tyre dhe Bankës së Shqipërisë, siç është theksuar dhe më sipër, janë shtuar takimet dhe kontaktet midis palëve.

*Probleme që lidhen me kuadrin e brendshëm rregullativ të bankave.* Me zgjerimin e aktivitetit dhe rritjen e kompleksitetit të shërbimeve bankare, vazhdimisht lind nevoja për pasurimin dhe përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullativ. Ky problem është më i prekshëm për bankat e reja. Për këtë arsye, atyre u është kushtuar kujdes i veçantë, nëpërmjet ekzaminimeve më të shpeshta, për të vlerësuar plotësimin e politikave dhe procedurave të brendshme, si dhe cilësinë e tyre.

Edhe në këtë drejtim, bankat në përgjithësi kanë reaguar mirë, por është e nevojshme që politikat dhe rregulloret e brendshme të jenë të miratuara edhe nga këshillat drejtues.

Lidhur me zbatimin e kuadrit të brendshëm rregullativ, vihen re shmangie nga disa banka. Në këtë kontekst është rekomanduar rritja e përgjegjësisë dhe cilësisë të punës së kontrollit të brendshëm dhe komitetit të kontrollit.

*Probleme që lidhen me zbatimin e rregulloreve.* Megjithëse ka patur përpjekje nga bankat për një zbatim sa më të mirë të kuadrit rregullativ të Bankës së Shqipërisë, përsëri vihen re moszbatime të rregulloreve apo shkelje të kufijve, të përcaktuar në to, në disa raste edhe përsëritje të shkeljeve.

Rregulloret për të cilat vihen re më tepër shkelje janë:

- a. Rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë”. Klasifikimi i kredive dhe shtesa e provigjoneve për kreditë e riklasifikuara, kanë qenë nga problemet e ndeshura më shpesh. Analiza më të thella financiare të kredimarrësve, vizitat në vend, plotësimi i dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm, janë disa nga rekomandimet për procesin kreditues të bankave.
- b. Rregullorja “Për kontrollin e rreziqeve të mëdha”. Tejkalimet e kufijve të përqendrimit për një përfitues, vihen re kryesisht për vendosje në banka (sidomos nga degët e bankave të huaja) dhe për kredi të dhëna.
- c. Rregullorja “Për pozicionet e hapura valutore”. Ekziston një numër i vogël bankash, të cilat kanë shkelur kërkesat e kësaj rregulloreje.
- d. Rregullorja “Për veprimtarinë valutore”. Vërejtjet për zbatimin e kësaj rregulloreje lidhen kryesisht me qëllimin e transfertave dhe dokumentimin e tyre me anë të aktzhdoganimeve. Në mjaft banka është rekomanduar trajnimi i personelit me formatet dhe elementet e vlefshmërisë së aktzhdoganimeve, që pranohen si dokumente justifikuese për transfertat tregtare.
- e. Rregullorja “Për parandalimin e pastrimit të parave”. Janë lënë rekomandime, për caktimin e personave përgjegjës në bankë për parandalimin e pastrimit të parave, për identifikimin e klientëve dhe raportimin e transaksioneve sipas kufijve të caktuar, si edhe në drejtim të trainimit të personelit për parandalimin e pastrimit të parave.
- f. Rregullorja “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”. Shkeljet më të vërejtura të kësaj rregulloreje lidhen me hartimin e strategjisë së teknologjisë së informacionit dhe të procedurave për zbatimin e kësaj strategjie. Janë lënë rekomandime për përmirësimin e politikave dhe procedurave për vlerësimin e rrezikut të teknologjisë së informacionit dhe dokumentimit të tij, për krijimin e strukturave organizative të nevojshme për sigurimin e cilësisë së teknologjisë së informacionit dhe auditimit të saj, për hartimin e planit të rekuperimit në raste fatkeqësish, për gjenerimin automatik të informacioneve të nevojshme, për ndarjen e të drejtave lidhur me hedhjen e të dhënave dhe autorizimet e veprimeve etj..

Në raportet e ekzaminimeve të këtij viti është për t'u vlerësuar reagimi pozitiv i disa bankave lidhur me rekomandimet e dhëna. Por, përsëri rezulton se një pjesë e mirë e këtyre problemeve, vazhdojnë të ekzistojnë. Për shkak të kostove të larta që shoqërojnë ndryshimet e nevojshme në këto sisteme dhe të varësisë nga politika e bankës-mëmë për filialet apo degët e saj, bankat po reagojnë relativisht ngadalë.

*Probleme që lidhen me kontabilitetin.* Problemet që kanë të bëjnë me zbatimin e Manualit të Kontabilitetit Bankar, burojnë nga fakti që bankat janë lejuar të mbajnë kapitalin në valutë të huaj. Disa nga bankat, vazhdojnë të mbajnë fitimin dhe aktivet e qëndrueshme në monedhë të huaj, në kundërshtim me Manualin e Kontabilitetit Bankar.

*Probleme të tjera.* Probleme të tjera të evidentuara gjatë ekzaminimeve, kanë të bëjnë me arritjen e objektivave të vendosur në planbuxhetet, me shtimin e personelit dhe trajnimin e tij, me përmirësimet në pagat e punonjësve, me rrjedhjet e personelit në disa banka, me transparencën me klientelën etj..

Ekzaminimet e pjeshme.

Ekzaminimet e pjeshme kanë patur si qëllim:

*Vlerësimin e realizimit të rekomandimeve të ekzaminimeve të plota.* Gjatë vitit 2006 janë kryer 14 ekzaminime të pjeshme, për verifikimin e realizimit të rekomandimeve të ekzaminimeve të plota nga ku ka rezultuar se bankat, kanë reaguar përgjithësisht pozitivisht ndaj këtyre rekomandimeve.

*Vlerësimi i politikave dhe i procedurave për PPP/PFT.* Në periudhën 30 janar deri më 1 shkurt 2006, u krye një ekzaminim i pjeshëm në 7 banka për vlerësimin e masave organizative dhe procedurale, për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit. Nga ekzaminimet në vend, rezulton se përgjithësisht bankat kanë krijuar njësitë përgjegjëse të PPP/PFT, të cilat operojnë në qendër, por nuk janë të shtrira dhe në të gjitha degët apo agjencitë e tyre. Kjo strukturë duhet të funksionojë në të gjithë rrjetin e bankave, për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për PPP/PFT dhe në degët përkatëse të bankave. Nga ekzaminimi rezulton se bankat në përgjithësi, kanë ngritur kuadrin e brendshëm rregullativ e procedural, që lidhet me rregulloren dhe procedurat për parandalimin e pastrimit të parave si dhe me udhëzimin "Si të njohim klientin". Si rekomandim i përgjithshëm, në të gjitha bankat është vendosur krijimi i bazës së të dhënave për identifikimin dhe regjistrimin e të dhënave ekonomike dhe financiare të klientëve (krijimi i profilit të klientit) që do të shërbejë për vlerësimin dhe identifikimin e transaksioneve, potencialisht të lidhura me veprimtari të paligjshme.



## 2.2 INSTITUCIONE JOBANKA

Problematika e inspektimeve.

Gjatë vitit 2006 janë ekzaminuar pesë institucione financiare jobanka. Problematika e evidentuar gjatë ekzaminimeve paraqitet si më poshtë:

*Shkelja e normave mbikëqyrëse dhe raportimet.* Këto shkelje kanë të bëjnë me normat e kredive me probleme dhe provigjonimin e tyre (për të dyja institucionet që ofrojnë kredi), me normat e likuiditetit dhe të kapitalit. Edhe raportimet që duhet të kryejnë këto institucione, nuk janë gjithmonë të rregullta dhe në kohën e duhur. Janë evidentuar dhe raste të shkeljeve të shumta të akteve ligjore dhe nënligjore, deri në papërgjegjshmëri të drejtuesve të subjekteve jobanka për të cilat janë dhënë masa ndëshkuese.

*Shkelja e kushteve të licencës.* Shkeljet e evidentuara të kushteve të licencës jepen më poshtë:

- a. Prania e tepricave kreditore në llogaritë e pasivit, të hapura nga institucionet për klientët. Në këto raste, është kërkuar që në marrëveshjen e nënshkruar nga të dyja palët, të përcaktohet qartë qëllimi i hapjes së llogarisë (vetëm për veprimtaritë e lejuara nga licenca).
- b. Prania e tepricave negative në llogaritë e klientëve (e ngjashme me kreditë "overdraft"). Në këto raste, është kërkuar ndërprerja e menjëhershme e kësaj praktike dhe kthimi i tepricave të llogarive në gjendje zero.

*Probleme të sistemeve të regjistrimit të informacionit.* Disa nga këto institucione e kanë filluar aktivitetin e tyre me nivele modeste të veprimtarisë dhe të kapitalit, dhe transaksionet e tyre nuk janë komplekse. Për këto arsye, sistemet që përdorin për kontabilizimet dhe ruajtjen e informacionit janë manuale. Me rritjen e aktivitetit dhe të aktiveve që kanë nevojë për monitorim të kujdesshëm, si dhe për të ruajtur informacionin në përputhje me kërkesat e ligjit, këto sisteme nuk i përmbushin më kërkesat. Në këto raste, është rekomanduar të sigurohet një sistem informacioni i përshtatshëm dhe i automatizuar, në të cilin të regjistrohen saktësisht të gjitha veprimet dhe të gjenerohet informacioni i nevojshëm për raportime në Bankën e Shqipërisë dhe tek autoritetet e tjera. Nga ana tjetër, është e nevojshme që këto institucione të njohin më mirë dhe të zbatojnë me rigorozitet Manualin e Kontabilitetit Bankar (ato pjesë të tij që mbulojnë veprimtaritë e tyre të licencuara).

*Rekomandime të tjera.* Rekomandimet e tjera kanë patur si qëllim shtimin e masave për të monitoruar dhe për t'u mbrojtur nga rreziqet e aktivitetit, luftën kundër pastrimit të parave, përmirësimin e strukturës dhe të kuadrit të brendshëm rregullativ, zbatimin rigoroz të rregulloreve "Për veprimtarinë valutore", "Për administrimin e rrezikut të kredisë", "Për parandalimin e pastrimit të parave", "Për raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore" etj..

### 2.3 UNIONET E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT

Gjatë vitit 2006 janë organizuar dy ekzaminime të plota në dy unionet e shoqërive të kursim-kreditit që mbledhin depozita nga anëtarët e tyre dhe ofrojnë kredi për ta. Gjatë ekzaminimit, rezultoi se veprimtaria e unionit dhe anëtarëve të tij në përgjithësi është në përputhje me ligjin dhe me kuadrin rregullativ, të miratuar deri tani. Për disa prej SHKK-ve anëtare, të cilat kishin shmangie të disa treguesve nga normat mbikëqyrëse, u la detyrë sjellja e tyre në normë, brenda afateve të përcaktuara. Rekomandimet e tjera kanë të bëjnë me: unioni të kreditojë direkt SHKK-të dhe këto të fundit të kreditojnë anëtarët e tyre; përmirësimin e strukturave kontrolluese të unioneve dhe SHKK-ve; përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullativ në drejtim të kreditimit dhe të mbledhjes të depozitave, të parandalimit të pastrimit të parave dhe likuiditetit; përmirësimin e procedurave në drejtim të analizës së kredidhënies dhe trainimit të punonjësve përkatës; hyrjen e sistemeve të reja informatike dhe përmirësimin me politika dhe procedura të atyre ekzistuese.

### 2.4 ZYRAT E KËMBIMEVE VALUTORE

Gjatë vitit 2006, janë inspektuar rreth 54 zyra të këmbimit valutor dhe ndër problemet kryesore të evidentuara mund të përmendim: mosmbajtjen e kontabilitetit në përputhje me ligjin; mosruajtjen e kopjeve të faturave për çdo veprim këmbimi; raportime jo të rregullta në Bankën e Shqipërisë; persona të punësuar jashtë listës së miratuar nga Banka e Shqipërisë etj.. Për këto probleme janë lënë rekomandimet përkatëse si dhe janë marrë masa për disa nga zyrat më problematike.

## 3. STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT DHE TË RAPORTIMIT FINANCIAR DHE SFIDAT E ZBATIMIT NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

### 3.1 RËNDËSIA E PËRSHTATJES DHE E ZBATIMIT

Në ditët tona është arritur një konsensus i gjerë për rëndësinë e përshtatjes (të adoptimit) dhe kthimit në standarde kombëtare, të atyre që aktualisht njihen si Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS)<sup>1</sup>. Në nivel ndërkombëtar, hartimi i një kuadri të unifikuar standardesh në fushën e kontabilitetit dhe të raportimit financiar, është një proces i cili është mbështetur fuqimisht<sup>2</sup> nga vendet e zhvilluara ekonomisht, nga institucionet financiare dhe sipërmarrjet e fuqishme të biznesit që veprojnë në këto vende, nga autoritetet rregullatore të tyre si edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare. Ky është një fenomen i kuptueshëm, në kushtet kur hapja e tregjeve të mallrave dhe kapitaleve si edhe integrimi i tregjeve financiare, diktojnë nevojën e krijimit të një fushe veprimi me rregulla të qartë dhe sa më të ngjashëm, të lojës.

Në përgjithësi, institucionet rregullatore të tregut financiar kanë një interes parësor në sigurimin e standardeve të unifikuara në fushën e kontabilitetit dhe të raportimit financiar. Ky interes është shumëplanësh, por mund të thuhet se pranimi i standardeve të unifikuara në këtë fushë, jep një kontribut bazë të rëndësishëm në sigurimin dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit. Më konkretisht, vendosja dhe adoptimi i këtyre standardeve, ndihmon në:

- a. *rritjen e transparencës financiare* nëpërmjet: ofrimit të një informacioni më të gjerë dhe më të saktë mbi tregjet financiare dhe pjesëmarrësit e tyre; perceptimit më të mirë të vlerës ekonomike të një njësie biznesi; publikimeve që fokusohen në analizën e rrezikut që shoqëron veprimtari të caktuara të njësisë së biznesit; një informacioni më të mirë për autoritetet mbikëqyrëse, i cili ndihmon në vlerësimin më të mirë të profilit të rrezikut të njësisë së biznesit etj.;
- b. *tërheqjen e investimeve* nëpërmjet: rritjes së transparencës dhe përmirësimit të cilësisë së informacionit, i cili iu ofron investitorëve (aksionerët) ekzistues dhe atyre të mundshëm vendas ose të huaj, sigurinë e nevojshme në njohjen e tregut dhe në vlerësimin e drejtë të ecurisë, për të marrë më lehtë vendime të rëndësishme në drejtim të investimeve;
- c. *rritjen e eficiencës dhe uljen e kostove* nëpërmjet: shmangies së kërkesave rregullative për përputhje me standarde të tjera (lokale) të kontabilitetit dhe të raportimit financiar;
- d. *nxitjen e disiplinës në treg midis aktorëve të tregut financiar*, në kushtet kur rritja e transparencës do të ndikojë në identifikimin e institucioneve financiare problematike dhe do t'i shërbejë marrjes së masave korrektuese nga vetë institucioni, nga institucionet rregullatore si edhe nga tregu;
- e. *përmirësimin e informacionit që shfrytëzohet nga institucionet rregullatore dhe mbikëqyrëse*, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në kushtet kur krahasueshmëria e informacionit është përmirësuar;
- f. *përmirësimin e informacionit në lidhje me mbikëqyrjen e konsoliduar*, veçanërisht në rastet e institucioneve financiare që veprojnë në tregjet globale dhe/ose në sektorë të ndryshëm. Informacioni në këtë rast konsiderohet mjaft i rëndësishëm për njohjen e strukturës së grupit financiar, për identifikimin e saktë të zotëruesve të tij, të strukturave të lidhura me të etj.;
- g. *konvergimin e praktikave mbikëqyrëse*, për shembull për zbatimin e plotë të Direktivave Evropiane.

### 3.2 KOSTOT E PROCESIT DHE SFIDAT

Duhet pranuar dhe duhet njohur disa kosto që lidhen me zbatimin e plotë të këtyre standardeve. Kjo është e nevojshme në mënyrë që në vijim, të identifikohen mënyrat e duhura të përballimit të tyre, të ndërtohet një strategji kombëtare e sektoriale në përballimin e tyre dhe në zgjedhjen e një përqasjeje eficiente në zbatimin e standardeve.

Më konkretisht, kostot më të rëndësishme burojnë nga procesi i kalimit në standardet e reja. Gjatë këtij procesi, nevojitet ndryshimi i pjesëshëm i sistemeve

të teknologjisë së informacionit të institucioneve financiare, trainimi i plotë dhe në kohë i personelit, realizimi i ndryshimeve të nevojshme rregullative për t'iu përshtatur risive që sjellin standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar. Është gjithashtu e nevojshme që të ngrihen dhe të forcohen në kohë burimet njerëzore që do të orientojnë dhe do të ndjekin procesin e kalimit në standardet e reja, në sektorë të veçantë. Këtu veçohen strukturat rregullatore dhe mbikëqyrësit, auditorët e jashtëm si edhe ata të brendshëm të institucioneve financiare. Përgatitjet do të ishin të mangëta, nëse nuk do të ofrohej mundësia e edukimit të përshkallëzuar me këto standarde, edhe për përdoruesit e gjerë të pasqyrave financiare të ndërtuara mbi bazën e standardeve të reja. Duhet pranuar që niveli i kompleksitetit që ofrojnë standardet e reja, kërkon njohuri më specifike edhe nga ana e përdoruesve të tyre.

Vëmendje e veçantë në procesin e zbatimit të standardeve të reja, i duhet kushtuar interpretimit që do t'i bëhet "luhatshmërisë", që do të shfaqet në elemente të veçanta të pasqyrave financiare. Për shembull, nevoja e vlerësimit me vlerë tregu, e aktiveve financiare. Në këto raste, është e rëndësishme të njihet saktë metodologjia e vlerësimit dhe modelet e kontabilizimit që janë përdorur (të përziera ose jo) si edhe të gjykohet nëse ato reflektojnë qartë realitetin ekonomik. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e vendeve në zhvillim, kur tregje të veçanta janë të segmentuara dhe të pazhvilluara, duke e bërë të vështirë përcaktimin e vlerës së produkteve që tregtohen.

Raportet që do të vendosen mes IFRS dhe kërkesave të kuadrit rregullativ mbikëqyrës në drejtim të raportimit financiar, janë një element kritik në zbatimin e standardeve. Sa më të mëdha të jenë ndryshimet në këtë rast, aq më e vështirë është për autoritetet mbikëqyrëse si edhe për strukturat drejtuese të institucioneve financiare, që të njohin pozicionin e vërtetë financiar të institucionit. Ky raport komplikohet, nëse merret parasysh në arsyetim edhe statusi i institucionit, si entitet më vete dhe/ose si pjesë e një grupi. Për shembull, në rastin e një grupi financiar që operon në zonën e Bashkimit Evropian dhe që ka akses në tregjet e kapitalit, Direktivat Evropianë<sup>3</sup> parashikojnë që grupi duhet të zbatojë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar. Për entitetet financiare që janë pjesë e grupit, që operojnë në juridiksione të ndryshme dhe që i nënshtrohen standardeve lokale, kostot e përputhshmërisë në nivel lokal dhe në nivel grupi, janë të rëndësishme. Mospërputhjet shkaktojnë konfuzion dhe humbje të besueshmërisë në treg, vlerësime të ndryshme nga ana e autoriteteve mbikëqyrëse dhe nga strukturat drejtuese të bankës për qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe shpesh, mund të nxisin konkurrencën mes autoriteteve mbikëqyrëse në juridiksione të ndryshme për pranimin e standardit më të ulët. Duke u nisur nga ky fakt, Komiteti i Mbikëqyrësve Evropianë të Bankave (CEBS<sup>4</sup>) ka përgatitur disa udhëzime<sup>5</sup> mbi interpretimet në lidhje me përshtatjen mes përcaktimeve të IFRS dhe të atyre mbikëqyrëse, veçanërisht lidhur me marrëdhënien mes borxhit dhe kapitalit në kuadër të llogaritjes së kapitalit rregullator, të mënyrës së ndërtimit dhe të raportimit të pasqyrave financiare etj..

Mjaft e rëndësishme është forma e pranimit të këtyre standardeve<sup>6</sup> dhe mënyra e interpretimit të tyre. Nëse këto do të pranohen dhe do të zbatohen

si parime, atëherë është e nevojshme që të forcohet mekanizmi i imponimit të tyre. Kjo mund të arrihet duke përfshirë strukturat përgjegjëse për të verifikuar konsistencën e zbatueshmërisë në sektorë të veçantë si edhe lidhjet që përcaktojnë marrëdhëniet midis këtyre strukturave në drejtim të koordinimit, të interpretimit të rasteve dhe të adoptimit të qëndrimeve të unifikuara.

Ndryshimet konkrete që sjellin IFRS janë të shumta dhe nuk mund të përmenden të gjitha në këtë analizë të përmbledhur. Megjithatë, disa prej tyre lidhen me:

- a. parimet e krijimit të fondeve rezervë për huatë;
- b. vlerësimin me vlerë tregu të aktiveve financiare dhe ofrimin e opsionit për të realizuar një gjë të tillë edhe për aktivet fikse;
- c. kërkesat për konsolidim të të gjitha investimeve (duke përfshirë edhe ato në kompani që nuk bëjnë pjesë në sektorin financiar), në rastin kur ky investim nuk është i përkohshëm;
- d. dallimin midis *leasing*-ut financiar dhe atij operacional;
- e. pagesat e dividendëve dhe mosnjohjen e tyre si një detyrim, nëse deklarohen pas datës së pasqyrave financiare;
- f. përgatitjen e pasqyrave të *cash-flow* dhe të ndryshimeve në kapitalin aksioner etj..

### 3.3 RASTI I SHQIPËRISË

Me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (i ndryshuar), zbatimi i plotë i IFRS do të jetë i detyruar për institucionet financiare dhe sistemin bankar, duke filluar prej vitit 2008. Kjo do të thotë që për qëllime të krahasimit edhe viti 2007, duhet të jetë me standardet e reja. Jemi në kufijtë e fundit kohorë kur duhet të fillojmë të veprojmë me shpejtësi në lidhje me ndërtimin e një strategjie për përjasjen ndaj këtij projekti të rëndësishëm.

Duke vlerësuar pozitivisht përpjekjet që po bëhen nga autoritetet shtetërore në përgjithësi, nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, nga institucionet rregullatore dhe mbikëqyrëse të pjesëve të ndryshme të tregut financiar, si edhe duke njohur dhe vlerësuar asistencën e institucioneve financiare ndërkombëtare në këtë drejtim (Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar), duhet pranuar që ende nuk është bërë e njohur një strategji<sup>7</sup> e mirëfilltë për zbatimin e IFRS në nivel kombëtar, për aktorët ekonomikë në tërësi<sup>8</sup> dhe për tregun financiar.

Ky problem paraqitet i mprehtë edhe në institucionet rregullatore dhe mbikëqyrëse. Gjatë punës sonë në këtë drejtim, mbështetemi në Manualin e Kontabilitetit Bankar, i miratuar nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.820, datë 30.12.1998. Në momentin e hartimit (me ndihmën e ekspertizës së huaj) dhe të miratimit të tij, mund të thuhet se ai ishte gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (IAS), të publikuara deri në atë kohë. Por që atëherë, standardet janë pasuruar dhe veprimtaria bankare

është bërë më e larmishme, duke e bërë urgjente nevojën e njohjes dhe të zbatimit të standardeve të reja, dhe ndryshimin e Manualit të Kontabilitetit Bankar<sup>9</sup>. Shtrohet në këtë rast si domosdoshmëri, njohja e standardeve nga mbikëqyrësit dhe përgatitja për zbatimin e plotë të tyre nga industria bankare<sup>10</sup>. Rasti i pjesës tjetër të tregut financiar, ku përfshihen shoqëritë e sigurimit, fondet e pensionit, kompanitë që veprojnë në fushën e letrave me vlerë etj., paraqitet edhe më i vështirë. Këtu mungon një manual specifik kontabiliteti, i cili do të ndihmonte në unifikimin e praktikave dhe do të lehtësonte punën e mbikëqyrësve.

Në lidhje me përgatitjet për zbatimin e IFRS, bankat paraqesin nivele të ndryshme. Disa nga bankat më aktive në treg, të cilat zotërohen ose i përkasin një grupi bankar me seli në Bashkimin Evropian, auditohen dhe përgatisin raportet financiare edhe mbi bazën e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (si pjesë e grupit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit të BE-së). Në përgjithësi mund të thuhet që këto banka kanë njohuri më të gjera për këto standarde dhe janë relativisht më të përgatitura për zbatimin e tyre. Në fakt, edhe në këtë rast, njohuritë mbeten të përqendruara në struktura apo punonjës të caktuar dhe më shumë duhet të bëhet për njohjen e tyre nga pjesa tjetër e personelit, veçanërisht nga strukturat drejtuese. Sidoqoftë, këto banka kanë "fatin" të mbështeten në këtë proces nga strukturat e specializuara të bankës-mëmë apo të grupit bankar.

Problemi paraqitet më i ndërlikuar në rastin e bankave të tjera, të cilat nuk e kanë një mbështetje të tillë teknike. Në këtë rast, auditimi kryhet kryesisht në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit, dhe njohuritë që strukturat e këtyre bankave kanë për IFRS, gjykohet se janë mjaft të kufizuara.

Në këto kushte si edhe në mungesë të kohës së mjaftueshme deri në afatin e zbatimit të standardeve që kërkon ligji, zgjidhja më e pranueshme është ajo që synon shfrytëzimin e njohurive në atë pjesë të institucioneve të tregut financiar, ku ato janë të mjaftueshme. Është fjala për afrimin e kompanive ndërkombëtare të auditimit të jashtëm, të cilat duhet të nxiten për të përcjellë njohuritë e tyre në këtë drejtim, tek aktorët e tjerë të tregut financiar. Gjithashtu, ekziston nevoja e koordinimit mes autoriteteve të tregut financiar, duke përfshirë institucionet rregullatore dhe mbikëqyrëse, në mënyrë që të realizohet fillimisht një vlerësim paraprak në industrinë financiare, në lidhje me shkallën e njohjes dhe problemet që do të lindin nga zbatimi i plotë i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar.

Në përfundim, theksojmë se zbatimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar nga bankat tregtare dhe tregu financiar në përgjithësi, është një detyrim ligjor. Ky është një projekt kompleks, por i nevojshëm për të vendosur tregun tonë financiar dhe institucionet e tij, në një pozitë më të mirë, në raport me institucionet financiare homologe të huaja, në kushtet e hapjes së tregut dhe integritetit të tij me tregjet financiare më të zhvilluara. Në të njëjtën kohë, besojmë se ky është një projekt në të cilin nevoja për të ecur shpejt, nuk duhet të na largojë vëmendjen nga problemet objektive që pritet të dalin me zbatimin e tij. Pavarësisht nga koha që do

të kërkojnë, këto çështje duhet të trajtohen duke synuar në një zgjidhje të qëndrueshme, e cila siguron stabilitetin financiar, mirëfunksionimin e tregut dhe të aktorëve të tij, si edhe reflekton realitetin ekonomik.

#### 4. PËRQENDRIMI DHE KONKURRENCA NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Sistemi bankar shqiptar vitet e fundit është karakterizuar nga zhvillime të rëndësishme strukturore. Rritja e numrit të bankave në sistem, ristrukturimi dhe privatizimi i bankave shtetërore, krijimi i bankave me kapital vendas, si dhe së fundi hyrja e bankave të huaja të fuqishme nëpërmjet blerjeve të bankave ekzistuese, e kanë shndërruar sistemin bankar shqiptar në një mjedis dinamik, në të cilin po vërehen gjithmonë e më shumë përpjekjet e bankave për t'u pozicionuar sa më mirë në treg. Këto zhvillime, natyrshëm çojnë në pyetjen se deri në ç'masë konkurrojnë bankat shqiptare me njëra-tjetrën.

Konkurrenca është një aspekt i rëndësishëm për sistemin bankar sepse, si në çdo treg, ajo ndikon eficiencën dhe cilësinë e produkteve të ofruara. Për më tepër, niveli i konkurrencës në sistemin bankar ka implikime edhe për sektorë të tjerë të ekonomisë. Kështu, evidencat empirike tregojnë se një nivel më i lartë konkurrence në sistemin bankar çon në rritje më të shpejtë të sektorëve të tjerë të ekonomisë, që mbështeten në financimet nga sistemi bankar (Claessens and Laeven, 2005). Gjithashtu, rezultatet e Deidda dhe Fattouh (2002) sugjerojnë se vendet në zhvillim kanë nevojë për një sistem bankar me konkurrencë më të lartë, për të nxitur rritjen ekonomike.

Nga ana tjetër, argumentohet se ekziston një lidhje e kundërt midis konkurrencës dhe stabilitetit në sektorin bankar. Sektori bankar konsiderohet një sektor i brishtë dhe me kosto sociale të lartë, në raste falimentimi. Vives (2001) argumenton se një konkurrencë e lartë në sistemin bankar, mund të çojë në marrje përsipër të një niveli të tepërt rreziku nga bankat, gjë që rrit mundësinë e falimentimit. Si rrjedhojë, për vendet në zhvillim do të ishte më i përshtatshëm një sistem bankar me konkurrencë të moderuar, duke qenë se për to është më e vështirë të ruajnë stabilitetin e tij, në prani të një konkurrence të lartë.

Nga sa u përmend më sipër, mund të thuhet se niveli optimal i konkurrencës në sistemin bankar nuk është unik, por varet nga zhvillimi ekonomik dhe institucional i një vendi. Për një ekonomi në zhvillim, një sistem bankar me konkurrencë të lartë do të ishte i dëshirueshëm, për të nxitur më shumë rritjen ekonomike, por në të njëjtën kohë mund të bëhej burim paqëndrueshmërie për sistemin financiar. Si rrjedhojë, është e rëndësishme të ndiqen me vëmendje zhvillimet në marrëdhëniet konkurruese të sistemit bankar, në mënyrë që të merren masat e duhura nëse është e nevojshme.

Përqendrimi në sistemin bankar shqiptar.

Analiza e strukturës së tregut është prej kohësh mënyra më e përdorur për të gjykuar mbi konkurrencën në një sistem bankar. Pavarësisht evidencës

empirike se struktura e tregut është përshkruese jo e mirë e konkurrencës, si dhe zhvillimit të metodave të tjera më të përparuara, indekset e përqendrimit të tregut vazhdojnë të përdoren si tregues plotësues në analizën e konkurrencës. Tabela 1 më poshtë, paraqet indeksin e përqendrimit Hirshman Herfindahl (HHI)<sup>11</sup>, të llogaritur për aktivet, për kredinë dhe për depozitat.

Tabelë 1. Indeksi HHI për sistemin bankar shqiptar, 1999 – 2006.


Indeksi HHI	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006*
Aktive	4,795	4,382	3,757	3,226	3,016	2,736	2,110	1,949
Kredi	3,316	2,727	2,011	1,729	1,459	1,150	1,035	1,035
Depozita	5,719	4,966	4,282	3,676	3,487	3,107	2,391	2,105

Burimi: Banka e Shqipërisë.

\*Korrik 2006.


Duke u bazuar në rregullin e Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së (1992) për interpretimin e HHI<sup>12</sup>, tregu bankar shqiptar klasifikohet si shumë

Grafik 1. Krahasimi me vendet e BE-së i indeksit HHI të aktiveve të sistemit bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe BQE (2005).

Grafik 2. Indeksi HHI i aktiveve, për Shqipërinë dhe vende të tjera të SEE.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe raporte të bankave të tjera qendrore.

i përqendruar në terma të aktiveve dhe depozitave, ndërkohë që karakterizohet nga një nivel i moderuar, shumë afër konkurrencës së plotë, i përqendrimit në aktivitetin e kredihënies. Pavarësisht nga fakti se niveli i përqendrimit të tregut të kredisë është në nivele të kënaqshme, përqendrimi i lartë i depozitave mbetet shqetësues, pasi, duke përbërë më shumë se 88 për qind të burimit të fondeve, depozitat janë faktori më i rëndësishëm që dikton kapacitetin kredihënës të bankave. Kjo sugjeron se pa rënie të mëtejshme të përqendrimit të depozitave, ka më pak të ngjarë të ruhet ky nivel përqendrimi në kredi apo të vërehet rënie e mëtejshme e tij, pa ndërmarrje të tepërt të rrezikut nga bankat e vogla dhe të mesme.

Për cilësimin e sistemit bankar shqiptar si “shumë” apo “pak” i përqendruar, ndihmon gjithashtu edhe krahasimi me vendet e tjera të rajonit dhe me ato të zhvilluara. Grafiku 1 paraqet indeksin HHI, të llogaritur për aktivet, për vendet e Bashkimit Evropian në vitin 2004 dhe për Shqipërinë, në vitet 2004 dhe 2006.

Krahasimi i mësipërm tregon se sistemi bankar shqiptar është më i përqendruar se sistemet e pjesës më të madhe të vendeve të Bashkimit Evropian. Sidoqoftë, ky nivel përqendrimi justifikohet deri-diku nga jetëgjatësia e shkurtër e sistemit tonë bankar dhe shkalla e tij e zhvillimit, krahasuar me vendet e BE-së. Megjithatë, siç duket qartë edhe nga krahasimi në grafikun 2 më poshtë, sistemi bankar shqiptar është gjithashtu më i përqendruari ndër vendet e Evropës Juglindore (SEE) të marra në konsideratë.



Nën këndvështrimin tradicional të konkurrencës, niveli i lartë i përqendrimit në sistemin bankar shqiptar nënkupton se shkalla e konkurrencës në të është e ulët dhe mbetet e tillë, pavarësisht prirjes së theksuar rënëse të përqendrimit në vite. Sidoqoftë, mungesa e evidencës së fortë empirike se treguesit e përqendrimit përshkruajnë saktë kushtet e konkurrencës në të cilën firmat operojnë, kërkon përdorimin e metodave të tjera më direkte, të matjes së konkurrencës.

#### Konkurrenca në sistemin bankar shqiptar

Për të matur konkurrencën e sistemit bankar shqiptar është aplikuar një metodologji e përparuar, e quajtur metodologjia Panzar-Rosse. Ajo është zhvilluar nga Panzar dhe Rosse në një seri publikimesh<sup>13</sup> dhe bazohet në Teorinë e Tregjeve të Kontestueshme (Contestable Market Theory, CMT), formuluar nga Baumol, Panzar dhe Willig (1982). CMT përfaqëson një këndvështrim të ri teorik ndaj konkurrencës, e cila zëvendësohet nga nocioni i kontestueshmërisë. Sipas kësaj teorie, pavarësisht nivelit të përqendrimit në një treg, konkurrenca mund të jetë thuajse perfekte nëse tregu është plotësisht i kontestueshëm: në të nuk ekzistojnë barrierat hyrjeje apo daljeje.


Në thelb të metodologjisë Panzar-Rosse qëndron fakti se, në varësi të nivelit të konkurrencës në treg, bankat shfaqin sjellje të ndryshme në përcaktimin e çmimeve, në përgjigje të ndryshimeve në kosto. Kështu, për të matur nivelin e konkurrencës me të cilin bankat ballafaqohen në treg, metodologjia Panzar-Rosse studion marrëdhënien mes të ardhurave të fituara nga bankat dhe kostove që janë krijuar për të gjeneruar këto të ardhura. Kjo arrihet nëpërmjet vlerësimit të një ekuacioni të reduktuar të të ardhurave, ku të ardhurat shprehen si funksion i kostove dhe variablave të tjerë që mund t'i ndikojnë, si madhësia, rreziku i ndërmarrë, shpërndarja gjeografike etj..

Duke qenë se variablat janë në formë logaritmike, secili prej koeficientëve përpara një variabli kostoje përfaqëson elasticitetin e të ardhurave ndaj atij variabli kostoje. Shuma e këtyre elasticiteteve, e quajtur *statistika H*, përbën pikërisht treguesin e përdorur nga metodologjia Panzar-Rosse për të matur konkurrencën në një industri. Duke patur parasysh karakteristikat e konkurrencës në tregje të ndryshme, *statistika H* përdoret për të matur konkurrencën si më poshtë:

$H=1$	evidencë për konkurrencë të plotë;
$H \leq 0$	monopol ose marrëveshje e fshehtë monopol;
$0 < H < 1$	konkurrencë monopolistike.

Për aplikimin e metodologjisë Panzar-Rosse, në rastin e Shqipërisë u përdorën të dhëna mbi banka individuale të sistemit bankar shqiptar, për periudhën 2000 – 2005. Vlera mesatare e *statistikës H* nga të gjitha vlerësimet është 0.5442, dhe në bazë të testeve të kryera rezultoi statistikisht pozitive dhe e ndryshme nga 0 dhe 1, duke treguar se bankat në Shqipëri operojnë në një mjedis me konkurrencë monopolistike. Kjo nënkupton se bankat në Shqipëri diferencohen nga njëra-tjetra, duke u fokusuar në segmente të ndryshme të


Grafik 3. Statistika H për sistemet bankare të Shqipërisë dhe disa vende të CEE dhe SEE.



tregut dhe/ose duke ofruar produkte me karakteristika të ndryshme, brenda të njëjtit segment. Ky është edhe rezultati më i hasur në studimet empirike për vendet e tjera. Siç argumentohet nga Allen dhe Gale (2001), konkurrenca në sisteme bankare është në përgjithësi monopolistike, pasi bankat nuk ofrojnë saktësisht produkte homogjene, por dallojnë në karakteristika të ndryshme të produkteve.

Krahasimi me vende të tjera është i vlefshëm për të patur një ide të përgjithshme se në ç’ nivele qëndron konkurrenca e tregut bankar shqiptar. Grafiku 3, paraqet vlerën mesatare të statistikës H për sistemin bankar shqiptar bashkë me statistikën H, për sistemet e disa prej vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEE) dhe të Evropës Juglindore (SEE).

Grafik 4. Statistika H për sistemet bankare në Shqipëri dhe në vende të zhvilluara.



Nga grafiku vërehet se niveli i konkurrencës në tregun bankar shqiptar është i krahasueshëm me tregjet bankare të vendeve të rajonit. Me përjashtim të bankave rumune dhe kroate, bankat shqiptare duket të operojnë në një ambient me konkurrencë më të lartë se sa vendet e tjera të Evropës Juglindore. Gjithashtu, edhe krahasimi me vendet e zhvilluara në botë, paraqitur në grafikun 4 më poshtë, tregon një pozicionim të kënaqshëm, duke patur parasysh zhvillimin dhe historinë e sistemit bankar shqiptar.

### Konkluzione

Sistemi bankar në Shqipëri karakterizohet nga një nivel i lartë përqendrimi dhe, pavarësisht prirjes së theksuar rënëse gjatë viteve, me rritjen e numrit të bankave dhe aktivitetit të tyre, treguesit e përqendrimit

janë më të lartë se në shumicën e vendeve të tjera të Evropës Juglindore dhe të Bashkimit Evropian. Megjithatë, bazuar në një metodologji më të sofistikuar të vlerësimit të konkurrencës, në krahasimet me vende të tjera të rajonit dhe ato më të zhvilluara, konkurrenca e sistemit bankar shqiptar gjykohet të jetë në nivele mesatare, të pranueshme për nivelin e zhvillimit të Shqipërisë, dhe jo e ulët, siç mund të nënkuptohet nga treguesit e përqendrimit të tregut.

Gjithashtu, nga krahasimet e nivelit të konkurrencës dhe përqendrimit, duket se bankat shqiptare operojnë në një mjedis me konkurrencë më të lartë se disa sisteme bankare që janë më pak të përqendruara. Ky vrojtim i thjeshtë, i shtohet evidencës së gjerë empirike se përqendrimi dhe konkurrenca nuk janë detyrimisht të lidhura midis tyre. Mbështetur në këtë evidencë, mund të konkludohet se përqendrimi në tregun bankar shqiptar nuk duhet të jetë aq shqetësues, sa duket nga treguesit e përqendrimit. Madje një nivel

i tillë përqendrimi për një vend në zhvillim si Shqipëria, lehtëson punën e mbikëqyrjes bankare dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit. Për më tepër, një konsolidim i mëtejshëm që rrit eficiencën dhe stabilitetin e sistemit edhe pse mund të çojë në rritje të përqendrimit, do të ishte gjithashtu i favorshëm, për sa kohë kushtet konkurruese mbeten të pacënuara.

## B. GJENDJA FINANCIARE E SISTEMIT BANKAR NË VITIN 2006

### 1. MJEDISI EKONOMIK NË VITIN 2006

Viti 2006 vijoi me zhvillime pozitive të ekonomisë botërore. Vlerësimet nga institucionet ndërkombëtare tregojnë se ekonomia botërore është rritur me 5.1 për qind, gjatë vitit 2006. Gjatë këtij viti, u evidentua një balancim i ekonomisë globale, me zhvillime të moderuara në ekonominë e SHBA dhe zhvillime më të shpejta në Evropë. Ecuria e ekonomive të Kinës, Indisë, Rusisë si edhe e disa vendeve të tjera në zhvillim, ka ndjekur zhvillimet pozitive të viteve të fundit, ndërsa vendet e rajonit dallohen për një rritje ekonomike më të shpejtë se Eurozona.

Politikat makroekonomike kanë vijuar të mbeten në kahun nxitës, ndonëse bankat më të mëdha qendrore kanë marrë masa për shtrëngimin e kushteve monetare, në përgjigje të shfaqjes së presioneve inflacioniste. Paniku që u krijua në tregje, për një ulje të mundshme të prodhimit të naftës nga vendet kryesore eksportuese të saj, si pasojë e tensioneve të shtuara gjeopolitike, ndikoi në rritje të çmimit në pjesën e parë të vitit dhe normalizim të tij në gjysmën e dytë, të vitit 2006. Këto zhvillime kanë tentuar të vënë në vështirësi qëndrueshmërinë e aktivitetit ekonomik, por pa arritur ta çenojnë atë. Gjithashtu, prirjet në rritje drejt globalizimit, të ekonomive vendore dhe rajonale, kanë dhënë një kontribut të dallueshëm në transmetimin e impulseve të rritjes ekonomike, përtej kufijve gjeografikë.

- **Ekonomia e Eurozonës**

Vlerësimet më të fundit konstatojnë një rritje të prodhimit të brendshëm bruto me 2.7 për qind në vitin 2006, nga 1.4 për qind në vitin 2005. Faktorët nxitës kryesorë për rritjen ekonomike, lidhen me rritjen e konsumit dhe të investimeve private. Përmirësimi i kërkesës së brendshme, ka hedhur bazat për një rritje të qëndrueshme. Të dhënat tregojnë se aktiviteti ekonomik në Eurozonë fitoi një ritëm të ri gjatë vitit 2006, ku rritja ekonomike ka qenë e shpërndarë mirë nga ana gjeografike. Kjo situatë e favorshme ekonomike e Eurozonës, i ka shërbyer një momenti të mirë për konsolidimin buxhetor në shumë vende.

Inflacioni i çmimeve të konsumit u rrit gjatë pjesës së parë të vitit, duke kulmuar me 2.5 për qind, në muajin qershor. Ndërsa politika monetare, e ndjekur nga BQE-ja ka ndihmuar në ankorimin e pritjeve të inflacionit rreth

objektivit 2 për qind. Tendenca e inflacionit të çmimeve të konsumit ndryshoi kah, gjatë pjesës së dytë të vitit. Në funksion të prirjeve dhe parashikimeve për inflacion, BQE vijoi me ciklin e shtrëngimit të politikës monetare. Gjatë vitit 2006 normat bazë të interesit u rritën 5 herë, duke arritur nivelin 3.5 për qind në fund të këtij viti.

- **Ekonomia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës**

Rritja ekonomike disavjeçare dhe me norma të larta për SHBA, filloi të ndryshojë gjatë vitit 2006. Ky vit u karakterizua nga një rritje ekonomike me normë mesatare, por gjithësesi të qëndrueshme. Rritja e lartë ekonomike në tremujorin e parë të vitit 2006, u moderua në vazhdim të tij. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik, duket të jetë i lidhur me zhvillimet negative në tregun e banesave dhe ndikimin e tyre në sektorin e ndërtimit. Megjithë këtë, shpenzimet konsumatore të cilat kanë qenë baza e rritjes gjatë viteve të fundit, kanë vijuar të jenë në nivele të larta. Kushtet shumë të mira financiare të sektorit të biznesit kanë mbështetur shpenzimet kapitale të biznesit, duke ndikuar në një kërkesë të qëndrueshme për punë.

Presionet inflacioniste janë qetësuar disi gjatë muajve të fundit të vitit, pas niveleve të larta të shënuara gjatë pjesës së parë. Banka Qendrore e SHBA-së (Federal Reserve) vijoi me politikën monetare shtrënguese, duke e rritur normën bazë të interesit në SHBA në nivelin 5.25 për qind, më e larta për ekonominë e mëdha. Kjo politikë u ndoq në pjesën e parë të vitit, për t'u pozicionuar më pas në pritje, pas 17 rritjesh të njëpasnjëshme të normës bazë të interesit. Kjo periudhë, duket se do të shërbejë për të kuptuar shkallën dhe intensitetin e materializimit të efektit të tyre në zhvillimet ekonomike.

- **Ekonomia e vendeve të rajonit<sup>14</sup>**

Zhvillimet ekonomike të vendeve të rajonit edhe gjatë vitit 2006, kanë tentuar drejt përafrimit me vendet e Evropës Perëndimore. Ritmet e rritjes ekonomike për këto vende, kanë qenë më të shpejta në krahasim me ato të Eurozonës. Rritja reale e produktit të brendshëm bruto pritet të jetë rreth 5.9 për qind, për vitin 2006 ndaj 4.7<sup>15</sup> për qind, në vitin 2005. Faktorët më kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e konsiderueshme ekonomike i janë flukset hyrëse nga investimet e huaja direkte dhe kërkesa e brendshme e lartë, e nxitur edhe nga rritja e shpejtë e kredive.

Kërkesa e brendshme dhe çmimet e larta të energjisë, duket të kenë ushtruar presione inflacioniste kudo në rajon. Gjithashtu, presionet në rritje ndaj cënimit të mundshëm të qëndrueshmërisë së stabilitetit financiar, me burim rritjen e shpejtë të portofolit të kredive apo të pagave reale, të reflektuara në kërkesën e brendshme të lartë, janë adresuar me vëmendje nga bankat qendrore të vendeve të rajonit. Në shumicën e rasteve, bankat qendrore kanë përforcuar masat rregullative dhe prudenciale, si edhe kanë qenë më të vëmendshme ndaj zhvillimeve monetare dhe inflacioniste.

- **Mjedisi ekonomik në Shqipëri**

Viti 2006 u karakterizua nga rritje ekonomike dhe stabilitet makroekonomik, si rrjedhojë e një politike makroekonomike mbështetëse, një politike monetare

të matur, respektimit të parametrave kryesorë nga ana e politikës fiskale, si dhe e zhvillimeve pozitive në sektorin financiar, veçanërisht në sistemin bankar.

Treguesit sasiorë dhe cilësorë të ecurisë ekonomike, flasin për një rritje të kënaqshme, të mbështetur kryesisht në aktivitetet e shërbimeve dhe të prodhimit industrial. Në bazë të treguesve të disponueshëm ekonomikë, norma e rritjes ekonomike vlerësohet të jetë rreth nivelit 5 për qind. Shitjet e realizuara nga ndërmarrjet ekonomike, gjatë nëntëmuajorit të parë, ishin rreth 11 për qind më të larta sesa në vitin 2005. Zhvillime pozitive janë regjistruar në sektorin e industrisë dhe në mënyrë të veçantë, në industrinë përpunuese. Aktiviteti tregtar në vend, vazhdon të sigurojë pjesën më të madhe të shitjeve, si edhe të shënojë ritme të konsiderueshme rritjeje vjetore. Sektori i ndërtimit vlerësohet të ketë patur një rritje, ndonëse më të ulët se sa në vitet e mëparshme. Prodhimi bujqësor është rritur në mënyrë modeste dhe është përqendruar në gjysmën e dytë të vitit. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik në vend është shoqëruar edhe me rritjen e shkëmbimeve tregtare me jashtë. Bilanci i pagesave është mbyllur në terma pozitivë, duke mbështetur qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit.

Kjo rritje është shoqëruar me stabilitet çmimesh, të shprehur në një inflacion mesatar vjetor prej 2.4 për qind apo normë inflacioni në fund të vitit, në nivelin 2.5 për qind. Inflacioni i çmimeve të mallrave të konsumit gjatë vitit 2006 është luhatur, në pjesën më të madhe, midis kufijve të intervalit 2 - 3 për qind, duke qenë afër objektivit prej 3 për qind të Bankës së Shqipërisë dhe brenda intervalit të tolerancës së saj. Presionet inflacioniste kanë ardhur në rritje, gjatë vitit 2006. Në kushtet e një inflacioni në rritje dhe në praninë e një numri faktorësh, që pritej të favorizonin rritjen e mëtejshme të çmimeve, Banka e Shqipërisë vendosi për një ndryshim të kahut të politikës monetare, në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2006. Ky ndryshim erdhi pas një periudhe neutraliteti, që zgjati rreth 1.5 vjet. Ndryshimi i kahut të politikës monetare, u materializua në dy rritje të normës bazë të interesit, gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2006. Në muajt korrik dhe nëntor 2006, norma e marrëveshjeve të riblerjes njëjavore u rrit përkatësisht me nga 0.25 pikë përqindjeje, duke nxitur krijimin e një ambienti më likuid në tregun bankar. Rritja totale me 0.5 pikë përqindjeje, vlerësohet të ketë normalizuar ritmet e rritjes vjetore të ofertës së parasë, duke iu përgjigjur në mënyrë më të plotë kërkesës për mjete monetare.

Kushtet monetare, të karakterizuara nga norma historikisht të ulëta interesi dhe qëndrueshmëri e kursit të këmbimit, kanë favorizuar rritjen e investimeve dhe të konsumit në ekonomi. Në mënyrë të veçantë, ato janë reflektuar edhe në rritjen e shpejtë të kredisë, duke mbështetur më tej rritjen e ekonomisë. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, vijoi të ruajë nivele të ulëta historike. Ky raport ishte 24.2 për qind, duke qenë 1.7 pikë përqindjeje më i ulët sesa ai i të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rënia e këtij raporti tregon se Banka e Shqipërisë dhe sistemi bankar kanë qenë më aktivë, se një vit më parë, në thithjen e parasë drejt kanaleve formale. Nga ana tjetër, zhvillimet fiskale kanë rezultuar brenda kufijve të programuar, duke kontribuar në konsolidimin e mëtejshëm të financave publike dhe në kontrollin e deficitit buxhetor.

Rritja ekonomike është reflektuar edhe në tregun e punës. Numri i të punësuarve në vend ka shënuar rritje. Sipas INSTAT-it, për sa i përket ndarjes sipas sektorëve privatë të ekonomisë, punësimi u rrit kryesisht në sektorët e tregtisë, të industrisë përpunuese dhe të ndërtimit, të cilët kanë qenë dhe sektorët kryesorë që kanë drejtuar rritjen ekonomike.

Zhvillimet në ambientin e jashtëm makroekonomik, janë pasqyruar në ekonominë shqiptare kryesisht nëpërmjet lëvizjeve në çmimin e naftës dhe në inflacionin e vendeve partnere. Tregu i brendshëm i karburanteve ka pasqyruar si rritjen, ashtu edhe uljen e çmimit të naftës jashtë. Ndikimi i kursit të këmbimit lek/usd në përcjelljen e çmimit të huaj në çmimin vendas, gjatë vitit 2006, ka qenë pothuajse i pandjeshëm. Ecuria e çmimeve të konsumit të partnerëve tregtarë të Shqipërisë, gjithashtu është reflektuar në çmimet e konsumit në vend. Ky fenomen është shfaqur më i fortë gjatë tremujorit të tretë, kur në Itali dhe Greqi u regjistruan rritje në çmimet e mallrave ushqimorë. Megjithatë, inflacioni i importuar vlerësohet të ketë qenë i moderuar, duke mos rrezikuar arritjen e objektivit të inflacionit në vend.

## 2. STRUKTURA E SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR

### 2.1 NUMRI I BANKAVE

Gjatë vitit 2006 sistemi bankar njohu zhvillime të rëndësishme sasiore dhe cilësore. Në fund të vitit, sektori bankar shqiptar përbëhej nga 17 banka, prej të cilave tre ishin me kapital tërësisht shqiptar.

Në fillim të vitit 2006 nisi aktivitetin e saj Banka Union. Në muajin shkurt, iu dha miratimi paraprak për licencë Bankës së Parë të Investimeve sh.a.. Kjo do të jetë filial i First Investment Bank, Bullgari.

Viti 2006 u karakterizua nga ndryshime në pronësinë e kapitalit të bankave si edhe në strukturën e aksionerëve të tyre. Këto ndryshime të aksionerëve të bankave tregojnë interesin e bankave dhe të grupeve të fuqishme bankare të huaja, për të investuar në kapitalin bankar shqiptar.

Konkretisht:

- Në maj të vitit 2006, u miratua shitja e 80 për qind të aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Italo Shqiptare, që i përkisnin Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Capitalia S.A., Itali tek aksioneri i ri SanPaolo IML S.p.A., Itali.
- Po në maj të këtij viti, u miratua transferimi i pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Kombëtare Tregtare nga Kent Bank / Bayindir Bank, tek aksioneri i ri Çalik-Seker Konsorsiyum Yatirim Anonim, në masën 60 për qind plus 2 aksione.
- Në gusht të vitit 2006, u miratua transferimi i pronësisë së aksioneve të kapitalit të Bankës ProCredit nga BERZH tek ProCredit Holding AG, në masën 11.25 për qind.

- Në tetor, u miratua transferimi i aksioneve të kapitalit të Bankës Emporiki S.A. të Greqisë tek aksioneri Credit Agricol S.A., Francë, në masën 71.97 për qind. Ky transferim ndikon edhe në pjesëmarrjen indirekte të Credit Agricol S.A. te kapitali aksioner i Bankës Emporiki, të Shqipërisë sh.a, në të njëjtën masë.

Ndryshime priten të ndodhin në aksionerët e Bankës Italo Shqiptare dhe të Bankës Amerikane të Shqipërisë. Aksioneri i Bankës Italo Shqiptare, SanPaolo IMI S.p.A. është përthithur nga Banka Intesa dhe është krijuar shoqëria Intesa SanPaolo S.p.A.. Kjo shoqëri, do të jetë aksionere edhe e Bankës Amerikane të Shqipërisë. Këto ndryshime do të miratohen nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2007, pas paraqitjes së dokumentacionit sipas kërkesave të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të rregullores “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”.

Dinamika e zgjerimit të rrjetit të bankave brenda territorit të Shqipërisë e nisur në vitet e mëparshme, vazhdoi edhe gjatë vitit 2006. Kështu, rrjeti i bankave u zgjerua edhe me 62 degë dhe agjenci të reja, me një shtrirje në të gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj, ku peshën më të madhe e zë rrethi i Tiranës me 30 degët dhe agjencitë e hapura. Shtrirja në Tiranë është në të gjithë territorin e saj, duke mbuluar me shërbime bankare si zonat periferike ashtu edhe zonat, ku janë përqendruar aktivitetet e biznesit, të prodhimit, të tregtisë dhe të shërbimit.

Gjatë vitit u dha miratimi për dy degë të bankave jashtë territorit të Shqipërisë dhe dy degë të tjera, janë në proces miratimi.

Tabelë 2. Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave, në fund të vitit 2006.

Nr.	Bankat	Nr. i degëve brenda vendit	Nr. i agjencive brenda vendit	Nr. i degëve jashtë Shqipërisë
1	Banka Raiffeisen	37	46	
2	Banka Kombëtare Tregtare	21	10	1 <sup>16</sup>
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	3	1	
4	Banka Italo Shqiptare		6	
5	Banka Italiane e Zhvillimit	1		
6	Banka Tirana	32	4	
7	Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë	4	6	
8	Banka Ndërkombëtare Tregtare	5		
9	Dega e Bankës Alfa	9	1	
10	Banka Amerikane e Shqipërisë	8	11	2
11	Banka ProCredit	21	1	
12	Dega e Bankës së Parë të Investimeve	1	2	
13	Banka Emporiki	3	4	
14	Banka e Kreditit të Shqipërisë	2	1	
15	Banka Credins	11	4	
16	Banka Popullore	29		
17	Banka Union	3	4	
	TOTALI	190	101	3

Gjatë vitit, janë paraqitur nga bankat 71 kërkesa për miratim administratorësh të emëruar prej tyre, si kërkesë e ligjit “Për bankat në



Republikën e Shqipërisë". Nuk ka patur vendime për refuzimin e miratimit të administratorëve të emëruar nga bankat.

Në vitin 2006 është kërkuar rritja e nivelit të licencës, nga niveli i parë në nivelin e dytë nga Banka Amerikane e Shqipërisë dhe Banka Italo Shqiptare. Pritet plotësimi i dokumentacionit nga bankat, në zbatim të rregullores përkatëse për dhënien e miratimit nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë është njoftuar për ndryshimet në statutet e bankave që lidhen me rritjen e kapitalit themeltar, ndryshimin e strukturës së aksionerëve dhe të pronësisë mbi aksionet, në masën nën 10 për qind të kapitalit të bankës etj.. Këto ndryshime, pasqyrohen në regjistrin e bankave që mbahet në Bankën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2006 u plotësua nga bankat niveli i kapitalit fillestar minimal të kërkuar dhe të regjistruar, në zbatim të vendimeve nr. 3 dhe nr. 4, datë 26.01.2005, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Për një ndryshim në rregulloren "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë".

Në Bankën e Shqipërisë u paraqitën 9 kërkesa për licencim të zyrave të këmbimit valutor dhe u dha licenca për këto zyra; si edhe iu revokua licenca, 7 zyrave të tjera.

Gjatë vitit 2006 u licencuan 4 shoqëri të reja të kursim-kreditit dhe iu revokua licenca 10 shoqërive të tjera. Shoqëritë e kursim-kreditit, të cilave iu është revokuar licenca, janë bashkuar mbi bazën e 6 shoqërive ekzistuese të kursim-kreditit.

Shoqëria "Partneri Shqiptar në Mikrokredi" sh.a. ka paraqitur kërkesën për licencë, për subjekt jobankë. Miratimi dhe dhënia e licencës për këtë subjekt, pritët të bëhet gjatë vitit 2007.

Në vitin 2006 nuk përfshihet më në subjektet jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë shoqëria "Tirana Leasing" sh.a., në zbatim të ligjit "Për qiranë financiare". Kjo shoqëri ka dorëzuar dokumentin e licencës në Bankën e Shqipërisë.

Njëkohësisht, subjekti jobankë Instituti Credins sh.a ka paraqitur kërkesën për miratim për kryerjen e një veprimtarie shtesë dhe konkretisht, të qirasë financiare. Ky aplikim është në fazën fillestare.

Gjatë vitit 2006, filloi miratimi i produkteve elektronike të përdorura nga bankat tregtare, në shërbim të klientelës. Ajo që vihet re është vendosja e shërbimeve të ATM-ve dhe emetimi i kartave të debitit dhe të kreditit, pothuajse në të gjitha bankat. Kjo jo vetëm rrit shpejtësinë e shërbimit, por edhe cilësinë e tij. Shërbimi i *e-banking* po ofrohet nga disa banka.

Në fund të vitit 2006, pas ndryshimeve të ndodhura, lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas viteve, paraqitet si më poshtë:

Tabelë 3. Numri i subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas viteve.

Nr.	Subjektet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	13	13	14	15	16	17	17
2	Subjekte financiare jobanka	2	4	5	7	7	7	6
3	Zyra të këmbimit valutor	19	38	58	58	54	58	60
4	Shoqëri të kursim- kreditit			113	131	130	131	125
5	Unione të shoqërive të kursim-kreditit			2	2	2	2	2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- Analiza financiare

Analiza financiare e sistemit bankar për vitin 2006, është mbështetur jo vetëm në vështrimin në kohë të ecurisë së sistemit në tërësi, por edhe në krahasimin brenda të njëjtës periudhë, të bankave me njëra-tjetrën, sipas disa kriterëve të caktuar. Për këtë qëllim, shërben ndarja e bankave në grupe, e cila bazohet mbi kriterin e madhësisë së aktiveve. Në këtë mënyrë, dallojmë tre grupe kryesore:

- Grupin e bankave me totalin e aktiveve më të vogël se 2 për qind - G1.
- Grupin e bankave me totalin e aktiveve më të madh se 2 për qind, por më të vogël se 7 për qind -G2.
- Grupin e bankave me totalin e aktiveve më të madh se 7 për qind - G3.

Gjatë vitit 2006, bankat u grupuan si më poshtë:

- Grupi 1(G1): Banka Emporiki (BE); Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH); Dega në Tiranë e Bankës së Parë të Investimeve (BPI); Banka Ndërkombëtare Tregtare (BNT); Banka e Kreditit e Shqipërisë (BKSh); Banka Italiane e Zhvillimit (BIZH);
- Grupi 2 (G2): Dega në Tiranë e Bankës Alfa (BA); Banka Italo-Shqiptare (BISh); Banka Procredit (BPC); Dega në Tiranë e Bankës Kombëtare të Greqisë (BKG); Banka Credins (BC); Banka Popullore (BP);
- Grupi 3 (G3): Banka Raiffeisen (BRF); Banka Tirana (BT); Banka Amerikane e Shqipërisë (BASH); Banka Kombëtare Tregtare (BKT).

## 2.2 STRUKTURA E PRONËSISË

Në vitin 2006, struktura e kapitalit të sistemit bankar sipas pronësisë, paraqet ndryshime të vogla krahasuar me vitin 2005. Kapitali i huaj vazhdon të zotërojë mbi atë vendas, duke zënë 85.7 për qind të kapitalit të sistemit ose rreth 0.6 pikë përqindje më pak se në vitin paraardhës. Brenda këtij grupi, vërehet një rritje e peshës së kapitalit nga vendet e Komunitetit Evropian, me rreth 3.3 pikë përqindjeje kundrejt rënies me 4 pikë përqindje të peshës së kapitalit nga vendet e tjera, ndërsa kapitali me origjinë nga SHBA ruan pothuajse të njëjtën peshë. Zhvillime të rëndësishme kanë prekur edhe grupin e kapitalit vendas. Një bankë e re me kapital shqiptar<sup>17</sup> iu shtua sistemit, duke

rritur peshën e kapitalit vendas privat në rreth 11.2 për qind, nga 7.8 për qind vitin e kaluar. Ndërkohë, shitja nga ana e Ministrisë së Financave e aksioneve që zotëronte pranë një banke, konsolidoi akoma më tepër prirjen rënëse të peshës së kapitalit shtetëror vendas, të shfaqur gjatë viteve të fundit.

I parë sipas grupbankave, grupi i bankave të mëdha G3 edhe për vitin 2006 vazhdon të mbështetet në burime të përhershme, tërësisht të huaja. Përsa i përket bankave të mesme G2 dhe atyre të vogla G1, struktura e kapitalit paraqitet si kombinim i kapitalit vendas me të huaj, ku ai i huaj zë një peshë më të madhe se 50 për qind.


### 2.3 NUMRI I PUNONJËSVE DHE I DEGËVE TË BANKAVE

Gjatë vitit 2006 vijoi me ritme të shpejta zgjerimi i sistemit bankar me degë dhe agjenci brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Numri i degëve dhe i agjencive, në vitin 2006, u rrit me 62 ose rreth 15 për qind më shumë se në vitin 2005. Përveç Tiranës (përfshirë qytetin dhe rrethin) ku u shtuan 30 degë dhe agjenci të reja, zgjerimi i rrjetit të bankave u karakterizua nga shtrirja në të gjithë territorin e vendit, përfshirë edhe qytete të vogla. Tirana mbetet rrethi me numrin më të madh të degëve dhe agjencive. Në fund të vitit 2006 numri i tyre në rrethin e Tiranës arriti në 98, që përbën rreth 33 për qind të totalit. Kjo shpjegohet me përqendrimin më të madh të popullsisë dhe bizneseve në këtë pjesë të territorit të Shqipërisë.

Puthuajse të gjitha bankat kanë hapur degë dhe agjenci të reja, gjatë vitit 2006. Peshën më të madhe në këtë zgjerim të rrjetit gjatë vitit 2006 e zënë bankat e mesme (Grupi G2), me 26 degë dhe agjenci të reja.


Numri i punonjësve të punësuar në sistemin bankar për vitin 2006 arriti në 4,189, me një rritje prej rreth 20 për qind në krahasim me vitin 2005. Në vitin 2006, rreth 62 për qind e totalit të punonjësve të bankave punojnë në degë dhe agjenci bankare. Edhe këtë vit, rritja e numrit të punonjësve të bankave lidhet me shtimin e degëve dhe të agjencive si edhe me zgjerimin e veprimtarisë bankare.

Grafik 5. Struktura e pronësisë së kapitalit të sistemit bankar, në vite.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Struktura e pronësisë së kapitalit sipas grupbankave.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7. Numri i degëve/agjencive (në përqindje) sipas grupbankave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8. Numri i punonjësve (në përqindje) sipas grupbankave në vite.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e numrit të bankave dhe degëve e agjencive të tyre nga njëra anë, si dhe rritja e numrit të punonjësve të bankave nga ana tjetër, kanë bërë që të përmirësohet dukshëm mbulimi i popullsisë me shërbime bankare dhe cilësia e tyre. Sipas të dhënave të tabelës të mëposhtme, numri mesatar i popullsisë për bankë është rritur. Ky tregues rezulton në rritje, pasi numri i bankave nuk ka ndryshuar nga viti 2005 deri në vitin 2006, ndërsa numri i popullsisë është supozuar që është rritur. Numri mesatar i popullsisë, për çdo njësi bankare dhe për çdo punonjës banke, rezulton me ulje për shkak të rritjes me ritme shumë më të larta të numrit të degëve dhe agjencive dhe të numrit të punonjësve, në krahasim me ritmet e rritjes së popullsisë.

Tabelë 4. Ecuria e numrit të punonjësve të sistemit bankar në vite.

	2003	2004	2005	2006
Numri i punonjësve	2,236	2,816	3,479	4,189
Numri i degëve, agjencive	161	188	250	294
Numri i punonjësve për :				
bankë	149	176	217	246
njësi bankare	13.9	15	13.9	14.2
Numri i banorëve për <sup>18</sup> :				
bankë	206,851	194,971	184,410	185,365
njësi banke	20,815	16,593	12,539	10,718
Punonjës banke	1,388	1,108	901	752

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe agjencive bankare, në fund të vitit 2006.

Nr.	Rrethet	TOTALI	Nr.	Rrethet	TOTALI
1	Tiranë	98	26	Gramsh	2
2	Sarandë	8	27	Librazhd	4
3	Kavajë	5	28	Peshkopi	2
4	Bilisht	4	29	Koplik	2
5	Durrës	22	30	Shijak	1
6	Fier	14	31	Delvinë	3
7	Elbasan	13	32	Divjakë	1
8	Korçë	11	33	Rrëshen	2
9	Shkodër	8	34	Krujë	3
10	Vlorë	13	35	Laç	4
11	Lezhë	6	36	Tepelenë	3
12	Pogradec	7	37	Bajram Curri	1
13	Berat	7	38	Bulqizë	1
14	Gjirokastrë	8	39	Çorovodë	2
15	Lushnje	7	40	Ersekë	1
16	Kukës	3	41	Krumë	1
17	Burrel	2	42	Pukë	2
18	Himarë	1	43	Peqin	1
19	Kakavijë	3	44	Fushë Krujë	1
20	Kuçovë	3	45	Athinë	1
21	Kamëz	1	46	Selanik	1
22	Shëngjin	2	47	Shkup	1
23	Kapshticë	2	48	Prishtinë	0
24	Përmet	4	49	Prizren	0
25	Ballsh	2		Gjithsej	294

Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 2.4 TEKNOLOGJIA E RE

Me miratimin nga ana e Bankës së Shqipërisë, të rregullores “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë”, gjatë vitit të fundit është vënë re një përmirësim i dukshëm i sistemeve informatike të bankave. Ky duket në përmirësimet e bëra në programet e përdorura dhe në blerjen e programeve të reja nga disa banka. Këto programe, mbështesin më mirë kërkesat e Manualit të Kontabilitetit Bankar si edhe nevojat e institucionit për zgjerim të veprimtarisë dhe prezantime të shërbimeve të reja, si për shembull *e-banking*. Kjo rregullore ka ndihmuar jo vetëm për një mbikëqyrje sa më korrekte dhe të plotë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të përdorur prej bankave por njëkohësisht, do të ndihmojë bankat në punën e përditshme dhe përdorimin e kësaj teknologjie. Rregullorja në fjalë, parashton masat e sigurisë që bankat duhet të aplikojnë për sigurimin dhe mirëpërdorimin e informacionit, për ruajtjen e këtij informacioni, për sigurimin e vazhdimësisë së punës në rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme. Gjithashtu, rregullorja thekson si mjaft të rëndësishëm dokumentimin e të gjitha veprimtarive kryesore të kryera nga punonjësit e departamenteve të teknologjisë dhe informacionit.

Por megjithë përmirësimet që rezultojnë, përsëri mbetet akoma shumë punë për t’u bërë në këtë fushë nga disa banka, sidomos në lidhje me vlerësimin e rrezikut si dhe me programet e përdorura prej tyre. Nga ana e Bankës së Shqipërisë është kërkuar dhe vazhdon të kërkohet, që bankat të hartojnë një metodologji të vlerësimit të rrezikut, të caktojnë nivelet e pranueshme të tij, si dhe masat që ndërmarrin për minimizimin ose edhe eliminimin e tij, në pikat më të ndjeshme të sistemeve të tyre. Ky vlerësim rreziku i cili duhet të kryhet, minimalisht një herë në vit, do të shërbejë si bazë për hartimin ose përmirësimin e politikës, të procedurave dhe të planeve të ndryshme të TIK, për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ndryshme, si dhe parandalimin ose minimizimin e ndërprerjeve të punës.

Një vëmendje e veçantë u duhet kushtuar të drejtave që kanë përdoruesit e sistemeve të ndryshme të TIK, përshtatshmërisë së këtyre të drejtave në lidhje me pozicionin që kanë përdoruesit në punën e përditshme, niveleve të aksesimit që ata kanë, si edhe kontrolleve të ndryshme, që duhet të ushtrohen herë pas here nga vetë bankat, në mënyrë që të shmangen mundësitë e keqpërdorimeve ose gabimeve të ndryshme.

Një sistem i rëndësishëm, të cilit i duhet kushtuar më shumë vëmendje është sistemi i SWIFT-it. Me zhvillimet që kanë pësuar aplikimet e ndryshme bankare, një pjesë e mirë e bankave kanë bërë automatizimin e gjenerimit të mesazheve të SWIFT-it, drejtpërdrejt nga aplikacioni bankar. Një detyrë e re, që u del bankave tashmë është rishikimi i profileve të përdoruesve të SWIFT-it, të para në kompleksitet me rolet që këta përdorues kanë në aplikacionin bankar (në ato banka ku SWIFT-i është i lidhur me aplikacionin bankar), në mënyrë që të respektohen të tre hapat e dërgimit të mesazheve (krijimi, verifikimi dhe autorizimi).

Një vëmendje e veçantë gjatë këtij viti, i është kushtuar edhe auditimit të brendshëm të bankave (ose edhe atij të jashtëm të ofruar nga kompanitë konsultante), i cili ka përfshirë edhe teknologjinë e informacionit. Kështu, janë audituar çështje të ndryshme që lidhen me funksionalitetin e aplikacioneve bankare të përdorura, me saktësinë e gjenerimit të informacionit, me ndryshimet e kryera në sistem, me sigurinë e informacionit gjatë punës dhe në transmetim, me planet e rekuperimit dhe rifillimit të punës, me analizën e rrezikut etj..

Ndryshimet më të fundit në teknologjinë e informacionit dhe *e-banking*.

Ndryshimet më të fundit në teknologjinë e informacionit, të cilat vlejné të përmenden, janë ato të lidhura kryesisht me përmirësimet e aplikimeve bankare të përdorura nga bankat, gjenerimin automatik të mesazheve të SWIFT-it, si dhe, me përmirësimet në shërbimet me anë të *e-banking*.

Përsa i përket përmirësimeve të aplikimeve bankare, mund të themi se një pjesë e bankave kanë përditësuar sistemet e tyre, duke kaluar në variante më të reja të këtyre aplikimeve. Kjo ka sjellë përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar përdoruesve të këtyre aplikacioneve si dhe rritjen e shpejtësisë së tij; shtimin e moduleve të ndryshme, gjë që ka sjellë saktësimin e informacionit; përputhjen me kërkesat rregullative të Bankës së Shqipërisë; uljen e nevojës për llogaritje manuale të treguesve të ndryshëm etj.. Gjithashtu, në lidhje me këtë aspekt vlen të përmendet se me kalimin në variante më të reja të aplikimeve bankare të përdorura, një pjesë e mirë e bankave kanë vendosur ndërfaqe, të cilat shërbejnë për komunikimin e këtyre aplikacioneve me SWIFT-in, duke kryer gjenerimin automatik të mesazheve të SWIFT-it. Në varësi të ndërfaqes, këto mesazhe të gjeneruara mund të jenë vetëm në fazën fillestare (vetëm të krijuara) ose në një shkallë më të lartë (të krijuara dhe të verifikuara) dhe u mbetet vetëm faza e tretë, që është autorizimi.

Në bazë të rregullores për "Mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike", të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 30 mars 2005 në bankingun elektronik janë të përfshira shërbimet e ATM-ve dhe POS-eve, si dhe shërbimet e ofruara nëpërmjet internetit.

Përsa i përket pjesës së parë të shërbimeve nga 17 banka, të cilat kryejné veprimtarinë e tyre në Shqipëri, 11 prej tyre ofrojnë shërbimet e ATM-ve dhe POS-ve, 4 janë në fazën e aplikimit për këtë shërbim dhe vetëm 2 prej tyre nuk e ofrojnë këtë shërbim. Megjithëse jo në nivelin e menduar, vihet re një rritje në përdorimin e kartave për kryerjen e pagesave të ndryshme. Rritja e pagesave të kryera me anë të kartave është ndikuar gjithashtu edhe nga fakti, që në bazë të marrëveshjeve midis bankave, mbajtësit e kartave ndërkombëtare të një banke si MasterCard dhe Visa mund të kryejné pagesa edhe nëpërmjet POS-eve të një banke tjetër.

Përsa i përket bankingut nëpërmjet internetit, përveç dy bankave të cilat kanë kohë që e ofrojnë këtë shërbim, shtatë banka të tjera janë në fazën e projektimit të ofrimit të tij. Megjithatë, përsëri ky shërbim mbetet i kufizuar vetëm në një rreth të ngushtë klientësh.

## 2.5 PËRQENDRIMI

Sistemi bankar në Shqipëri gjatë vitit 2006, ka vijuar me shfaqjen e tendencave pozitive në drejtim të shpërndarjes më të mirë të burimeve financiare dhe për rrjedhojë, edhe të aktiveve ndërmjet bankave. Vlerat e treguesit Herfindahl për depozitat dhe totalin e aktiveve, pasqyrohen dukshëm më të vogla sesa një vit më parë. Dinamika e këtyre treguesve është orientuar përgjithësisht drejt nivelit optimal të përqendrimit, ndonëse nivelet aktuale janë ende larg këtij të fundit. Veçojmë dinamikën e indeksit-H, për portofolin e kredive që shfaqet më e qëndrueshme në kohë, më afër nivelit optimal në krahasim me dy indekset e tjera, dhe që tregon për një shpërndarje më të mirë të aktivitetit të kredisë në sistemin bankar.

Zhvillimet pozitive në indeksin H për aktivet dhe depozitat, shpjegohen me rënien e peshës së tregut për Bankën Raiffeisen, rritjen e peshës së tregut sidomos për dy banka me kapital shqiptar, Banka "Credins" dhe Banka Popullore, si edhe me futjen në treg të një banke të re gjatë vitit 2006. Më konkretisht, pesha e aktiveve dhe e depozitave për Bankën Raiffeisen ka rënë me 4.6 për qind dhe 5.3 për qind, ndërkohë që është rritur pesha e Bankës "Credins" dhe e Bankës Popullore, të marra së bashku, përkatësisht me 2.6 për qind dhe 2.9 për qind. Me një dinamikë të spikatur vlerësohen edhe dy banka të mëdha, Banka Amerikane e Shqipërisë dhe Banka Kombëtare Tregtare, të cilat kanë njohur rritje të aktiveve dhe depozitave. Megjithë këto zhvillime pozitive, bankat më të mëdha të sistemit, vijojnë të mbizotërojnë aktivet dhe burimet kryesore të sistemit bankar. Pesha e depozitave të tyre ndaj totalit të sistemit bankar, përlllogaritet 71.8 për qind ndaj 75.7 për qind një vit më parë, ndërsa pesha e aktiveve 69.3 për qind ndaj 72.5 për qind.

Tabelë 6. Indeksi H (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë.


	Dhjetor'02	Dhjetor'03	Dhjetor'04	Dhjetor'05	Qershor'06	Shtator'06	Dhjetor'06
Indeksi H (aktivet)	0.32	0.30	0.27	0.21	0.20	0.18	0.18
Indeksi H (depozitat)	0.37	0.35	0.31	0.24	0.21	0.20	0.20
Indeksi H (kredia)	0.17	0.15	0.11	0.10	0.10	0.11	0.11

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlerësimi i konkurrencës në sistemin bankar përbën një çështje komplekse, e cila shkon përtej referimit të nivelit të përqendrimit të aktiveve, depozitave apo edhe kredive si masë vlerësimi. Konkurrenca në sistemin bankar, e parë në një optikë më të gjerë dhe objektive, i referohet shkallës së përparësive krahasuese që ofrojnë produkte, shërbime apo linja biznesi homogjene ndërmjet bankave të ndryshme. Në këtë këndvështrim, nuk disponohen vlerësime për sistemin bankar shqiptar. Megjithëkëtë, një vlerësim sasior sipas një modeli që tenton të përfshijë këtë koncept të avancuar të konkurrencës, tregon se konkurrenca në sistemin bankar në Shqipëri është në nivel mesatar<sup>19</sup>.

Vlerësuar në një vështrim empirik, konstatojmë se kushtet e konkurrencës në sistemin bankar në Shqipëri tentojnë kah përmirësimi nga njëri vit në tjetrin dhe për rrjedhojë, edhe gjatë vitit 2006. Shtrirja e rrjetit të bankave të ndryshme,

Grafik 9. Peshat e grupbankave në sistem sipas totalit të aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë

jo vetëm në zonat urbane të rëndësishme por edhe përtej tyre; ofrimi i një game më të gjerë shërbimesh dhe produktesh, jo vetëm nga një bankë apo një grup i vogël bankash por nga të gjitha bankat e sistemit; marketingu i intensifikuar mediatik si edhe përmirësimi në përgjithësi, i termave të biznesit ndërmjet bankave dhe klientëve, përfaqësojnë zhvillime të qenësishme drejt përmirësimit të klimës së konkurrencës në sistemin bankar.

## 2.6 AKTIVET DHE PASIVET

### 2.6.1 Totali i aktiveve dhe struktura e tyre.

Gjatë vitit 2006, aktivet e sistemit bankar u rritën me 127.7 miliardë lekë ose 25.7 për qind. Rritja vlerësohet rreth 57.6 miliardë lekë më e lartë se rritja e aktiveve për vitin 2005. Përjashtimisht bankave të mëdha, në zgjerimin e bilancit të sistemit kontribuan edhe disa banka të mesme apo të vogla. Vetëm tremujori i fundit, evidentoi rritje të aktivitetit bankar me 56.5 miliardë lekë ose rreth 10 për qind, nga 24.2 miliardë lekë ose 4.5 për qind, në tremujorin e mëparshëm.

Struktura e aktiveve të sistemit bankar vijon të evidentojë dinamikën kryesore në këta tregues:

- rënia e investimeve në bono thesari të Qeverisë Shqiptare me rreth 1.1 miliardë lekë ose 6.3 për qind, krahasuar me fundvitin e mëparshëm;
- tendenca në rritje e kredihënies me 55.5 për qind, duke rezultuar rreth 31.7 për qind e totalit të aktiveve të sistemit bankar; si edhe
- rritja e rëndësisë së investimeve në letra të tjera me vlerë, përjashtimisht bonove të thesarit të Qeverisë Shqiptare, me 31.6 miliardë lekë ose 52.2 për qind.


Investimet në letrat e tjera me vlerë, dallojnë peshën e konsiderueshme prej 82.5 për qind të obligacioneve të Qeverisë Shqiptare, shoqëruar nga obligacionet e qeverive të tjera të huaja prej 8.7 për qind. Ndërkohë, peshat e obligacioneve të emetuara nga banka të huaja dhe nga institucione të huaja financiare, llogariten respektivisht prej 6.1 për qind dhe 2.7 për qind. Këto të fundit, janë kryesisht të vlerësuara me rrezik të ulët nga kompanitë ndërkombëtare të *rating*-ut.

Ndikimin kryesor në rritjen e burimeve të sistemit bankar për vitin 2006 e dhanë depozitat e klientëve, me 87.3 miliardë lekë (duke shënuar rritje me 20.2 për qind), shoqëruar nga "veprimet me thesarin e ndërbankare" me 26.6 miliardë lekë (duke shënuar rritje me 129.4 për qind) dhe "burimet e përhershme" me 10.5 miliardë lekë (duke shënuar rritje me 29.6 për qind). Rritja e depozitave të sistemit tregon për një besim në rritje të publikut ndaj




sistemit bankar. Ajo është një tregues i reduktimit të informalitetit dhe i rritjes së eficiencës së kursimeve të popullatës në tërësi.

Grafik 10. Struktura e aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 11. Struktura e pasiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


### 3. ADMINISTRIMI I RREZIQEVE NË VEPRIMTARINË BANKARE

#### 3.1 RREZIKU I KREDITIT

##### 3.1.1 Aktiviteti kreditues.


Teprica e kredisë së sistemit bankar, gjatë vitit 2006, shënoi rritje me 70.2 miliardë lekë<sup>20</sup> ose 55 për qind, nga 57.6 miliardë lekë ose 82.1 për qind një vit më parë. Ecuria në rritje e kredihënies tregon për një kërkesë të lartë të komunitetit dhe ekonomisë për financim si edhe për gatishmërinë gjithnjë rritje të sektorit bankar, për të përmbushur këtë kërkesë.

Grafik 12. Teprica bruto e kredisë (në miliardë lekë).




Gjatë vitit 2006, evidentohen bankat e mëdha (G3) me ndikimin kryesor në rritjen e portofolit të kredisë së sistemit, me 43.3 miliardë lekë, shoqëruar nga bankat e mesme (G2) me 20.7 miliardë lekë dhe bankat e vogla (G1) me 6.2 miliardë lekë. Vetëm për tremujorin e fundit të vitit, teprica e kredisë së sistemit bankar shënoi rritje me 25.5 miliardë lekë ose 14.8 për qind, nga 15.4 miliardë lekë ose 9.8 për qind në tremujorin e mëparshëm. Kredia në valutë ka vazhduar të kontribuojë më shumë. Ndërsa teprica e kredisë në lekë u rrit me 5.9 miliardë lekë ose 11.9 për qind, teprica në monedhë të huaj shënoi rritje me 19.5 miliardë lekë ose 16 për qind.

Grafik 13. Kredia e re e akorduar nga sistemi bankar, mbi baza tremujore (në miliardë lekë).




Në rritjen e tepricës së kredisë për tremujorin e katërt, kontributin më të madh e kanë dhënë sërish grupet G3, G2 respektivisht me 17 miliardë lekë (ose 18.1 për qind), 7.1 miliardë lekë (ose 10.9 për qind), pasuar nga G1 me rreth 1.4 miliardë lekë (ose 10.3 për qind). Kjo periudhë ka thelluar efektin e kontributit të bankave të mëdha ndaj dy grupeve të tjera, në rritjen e tepricës së kredisë së sistemit. Tremujori i katërt, shënon rritjen e peshës së bankave të mëdha në totalin e portofolit të kredisë dhe reduktimin e peshës së grupeve të bankave të mesme dhe atyre të vogla.

Grafik 14. Peshat e grupbankave në totalin e tepricës së kredisë së sistemit bankar.



Viti 2006 dallon rritje të rëndësishme të kredisë së akorduar sektorit privat dhe individëve. Pavarësisht prirjes së dukshme në rritje të kredive për individë, sektori i korporatave vazhdon të jetë segmenti më i

Grafik 15. Vëllimi i tepricës së kredisë sipas sektorëve (në miliardë lekë).



preferuar. Rreth 67.4 për qind e rritjes së kredisë apo 26 miliardë lekë i përket këtij sektori, i cili mban peshën kryesore në stokun e kredive.

Struktura e kredisë sipas afatit dallon zhvendosje të kredisë afatshkurtër drejt asaj afatgjatë. Rritja e vëllimit të kredisë afatshkurtër, por me ritëm më të ulët rritës ndaj kategorive të tjera, shpjegon rënien e peshës së saj në strukturën e kredisë sipas afatit.

Tabelë 7. Struktura e tepricës së kredisë sipas afatit, në përqindje.

	Dhjetor'04	Mars'05	Qershor'05	Shtator'05	Dhjetor'05	Mars'06	Qershor'06	Shtat.'06	Dhjetor'06
afatshkurtër	33.8	34.0	34.2	32.4	33.2	33.0	32.1	31.5	30.8
afatmesme	35.3	33.9	33.1	32.3	30.6	29.9	30.9	31.6	30.8
afatgjatë	30.9	32.2	32.8	35.2	36.2	37.1	36.9	36.8	38.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Portofoli i kredive në lekë, megjithë dominimin e kredisë në valutë, prezanton ritëm rritjeje të konsiderueshëm. Kredia në lekë u rrit rreth 78.2 për qind në krahasim me fundvitin 2005. Për rrjedhojë, gjatë vitit 2006, pesha e portofolit të kredive në lekë ndaj totalit të portofolit të kredive, dallohet për një rritje të konsiderueshme nga niveli 24.4 për qind në 28.1 për qind. Zhvillimet në madhësinë e portofolit të kredive në lekë, ndonëse janë pozitive, vazhdojnë ta rendisin Shqipërinë ndër vendet me normën më të lartë në rajon, për portofolin e kredive në monedhë të huaj<sup>21</sup>.

Tabelë 8. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave (në përqindje).

	Dhjetor'04	Mars'05	Qershor'05	Shtator'05	Dhjetor'05	Mars'06	Qershor'06	Shtator'06	Dhjetor'06
në lekë	19.5	20.1	22.3	22.4	24.4	25.5	27.5	28.9	28.1
në valutë	80.5	79.9	77.7	77.6	75.6	74.5	72.5	71.1	71.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mbështetur në të dhënat historike dhe më të fundit të ecurisë së aktivitetit kreditues, vlerësohet një pritshmëri e rritjes së tepricës së kredisë mbi 70 miliardë lekë, gjatë vitit 2007. Ndërkohë, supozimi se madhësia e kapitalit rregullator të sistemit bankar do të mbetet e njëjtë deri në fundvitin 2007 (rasti më i keq i mundshëm, pasi nuk merr në konsideratë as fitimin ushtrimor të kësaj periudhe) lejon rritjen e tepricës së kredisë rreth 110 miliardë lekë, në mënyrë që norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të ruajë nivelin 12 për qind. Megjithëkëtë, një pjesë e konsiderueshme e bankave që janë aktive në treg, kanë norma mjaftueshmërie kapitali relativisht jo të përshtatshme për një kontribut të qënësishëm në rritjen e portofolit të huave gjatë vitit 2007. Banka të tjera, me potenciale më të mëdha kredituese dhe që synojnë të zgjerohen në kredidhënie, mendojmë se do të ndjekin përgjithësisht një strategji graduale. Vlerësojmë se edhe procesi i përafrimit me vendet e zhvilluara, përsa i përket peshës së portofolit të kredive në totalin e aktiveve, do të vijojë gjatë vitit 2007, ndonëse me ritme më të kontrolluara. Gjithashtu, kushtet makroekonomike dhe pritshmëritë për inflacionin dhe rritjen ekonomike, do të jenë faktorë të rëndësishëm në zgjerimin e portofolit të kredive në të ardhmen.

## 3.1.2 Cilësia e kredive.

Viti 2006 shënon rritjen e portofolit të kredive me probleme të sistemit bankar me rreth 3.1 miliardë lekë, nga 24 milionë lekë, që ishte rritja e këtij treguesi për vitin 2005. Gjykojmë që ritmet e konsiderueshme rritëse të kredisë së akorduar nga sektori bankar gjatë periudhave të fundit dhe mundësia e vogël e identifikimit dhe monitorimit të problemeve për kreditë e reja, pritej të pasqyronin përkeqësime të cilësisë në të ardhmen.

Në këtë mënyrë, treguesi që mat efektivitetin e administrimit të portofolit të kredisë, raporti “kredi me probleme (bruto)/ ndaj tepricës bruto të kredisë” llogaritet 3.1 për qind nga 2.3 për qind në fundvitin 2005.

Gjithashtu, edhe treguesi mbi baza neto<sup>22</sup>, i cili tregon madhësinë potenciale të ekspozimit të sistemit ndaj rrezikut të kredisë, shënon nivelin prej 1.4 për qind nga rreth 1 për qind, në të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Në krahasim me fundvitin 2005, struktura e kredisë sipas kategorive të cilësisë prezanton rritjen e peshave të tepricave të klasifikuara “nënstandarde”, “të dyshimta”, “të humbura”, si dhe reduktimin e kategorive “standarde” e “në ndjekje”.

Tabelë 9. Klasifikimi i kredisë në përqindje ndaj tepricës së kredisë.

Klasifikimi i kredisë	2004				2005				2006
	T IV	T I	T II	T III	T IV	T I	T II	T III	T IV
Kredi standarde	92.8	92.5	94.9	94.2	94.1	93.2	92.4	92.5	93.5
Kredi në ndjekje	3.2	4.1	2.8	3.4	3.6	3.8	3.9	4.3	3.4
Kredi nënstandarde	1.0	0.9	0.6	0.9	0.8	1.1	1.4	1.6	1.1
Kredi të dyshimta	1.0	0.9	0.5	0.4	0.5	1.0	1.5	0.7	0.9
Kredi të humbura	2.1	1.6	1.2	1.1	1.0	0.9	0.8	0.9	1.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Analiza e cilësisë së kredisë sipas sektorëve, tregon për një cilësi më të mirë të portofolit të kredive për individët. Kështu, raporti i kredive me probleme për individët ndaj totalit të kredisë dhënë individëve llogaritet 2.2 për qind, nga 3.5 për qind, që llogaritet ky raport për korporatat. Këta tregues besojmë se konfirmojnë rëndësinë e diversifikimit të portofolit, i cili është më i dukshëm në sektorin e individëve. Në të kundërt, përqendrimi i madh për sektorin e korporatave sjell efektin dominues të disa kredimarrësve, në cilësinë e portofolit të huave në total.

Ndonëse treguesit, që masin cilësinë e portofolit të kredisë sipas monedhave<sup>23</sup>, evidentojnë vlera më të ulëta për portofolin në lekë, tremujori i katërt prezanton përmirësimin e cilësisë së kredisë në valutë, kundrejt rritjes së raportit “kredi me probleme në lekë / totalit të kredisë në lekë”.

## 3.2 RREZIKU I LIKUIDITETIT


### 3.2.1 RAPORTET E LIKUIDITETIT

Në fund të vitit 2006, niveli i aktiveve likuide të sistemit paraqitet në rreth 359 miliardë lekë, duke u rritur me rreth 48 miliardë lekë ose 15.6 për qind krahasuar me fundvitin 2005. Pesha e tyre ndaj totalit të aktiveve ka rënë me rreth 5 pikë përqindje, rezultat i rritjes me ritme më të larta të aktiveve të sistemit. Gjykojmë që pesha e tyre ndaj totalit të aktiveve në nivelin 58 për qind, vijon të jetë e kënaqshme.

Investimet në bono thesari vazhdojnë të zënë pjesën kryesore të aktiveve likuide të sistemit, ndonëse kanë rënë ndjeshëm, me rreth 12 pikë përqindjeje krahasuar me fundvitin 2005.

Vlera e raportit tjetër të likuiditetit aktive afatshkurtra<sup>24</sup>/pasive afatshkurtra, tregon se sistemi bankar mbulon rreth 74 për qind të pasiveve afatshkurtra, me aktivet afatshkurtra. Siç vërehet edhe nga tabela e mëposhtme, vlera e treguesit ka ardhur në rënie gjatë tre viteve të fundit, megjithatë ai vazhdon të shfaqë nivele të cilat konsiderohen të kënaqshme.

Grafik 16. Përbërja e aktiveve likuide (dhjetor 2006).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi (në milionë lekë)	Dhjetor 2004	Dhjetor 2005	Dhjetor 2006
1. Aktive afatshkurtra	154,788	166,364	198,936
2. Pasive afatshkurtra	160,067	207,852	268,878
(1)/(2) (në %)	97	80	74

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 10. Ecuria e raportit të aktiveve afatshkurtra ndaj pasiveve afatshkurtra për sistemin bankar.

Raporti i gap-it të maturimit kumulativ deri në një muaj ndaj totalit të aktiveve, për tremujorin e fundit të vitit ka pësuar një përkeqësim të lehtë. Ky tregues është rritur në -11.2 për qind kundrejt -8.36 për qind, në fundvitin 2005.

Në fund të dhjetorit 2006, likuiditeti i sistemit paraqitet me tepriçë, ndërsa në shtrirje vjetore, niveli mesatar i tij ka qenë rreth 6.48 miliardë lekë në krahasim me 4.5 miliardë lekë, gjatë vitit 2005.

Bankat e sistemit kanë qenë më aktive në treg krahasuar me vitin 2005, gjë e cila është reflektuar në rritjen prej rreth 7 për qind të vëllimit mesatar mujor të transaksioneve ndërbankare. Përdorimi i instrumenteve të operacioneve të tregut të hapur, si marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, shitja/blerja e letrave me vlerë me të drejta të plota si edhe e lehtësive të tjera, të ofruara nga ana e Bankës së Shqipërisë, kanë ndihmuar bankat në administrimin e mirë të rrezikut të tyre të likuiditetit.

Administrimi i mirë i këtij rreziku merr rëndësi në këndvështrimin e rrezikut sistematik. Mosshlyerja e detyrimeve të një banke në tregun ndërbankar ndaj një ose më shumë bankave të sistemit, mund të shkaktojë paaftësinë paguese edhe në bankat e tjera në formën e një efekti domino, duke shkaktuar kolapsin e gjithë sistemit financiar. Në sistemin bankar në Shqipëri, ekspozimet që kanë bankat e sistemit tek njëra tjetra janë kryesisht afatshkurtra dhe konsiderohen pothuaj të parëndësishme. Ndërkohë, vëllimet dhe numri i veprimeve në tregun ndërbankar ende mbeten të kufizuara. Gjithashtu, funksionimi prej disa kohësh i sistemit të pagesave në kohë reale, mendojmë se jo vetëm që ka inkurajuar bankat për të administruar më mirë likuiditetet operationale, por ka reduktuar edhe akumulimin ditor të ekspozimeve, që mund të jetë me pasoja në rrethana të caktuara.

Gjendja e likuiditetit të sistemit tonë bankar konsiderohet e kënaqshme gjatë vitit 2006. Depozitat pranë bankave kanë ruajtur prirjen rritëse. Politika monetare e kujdesshme e Bankës së Shqipërisë për mbajtjen nën kontroll të inflacionit dhe norma reale të kthimit në lekë, rritja e normave të interesit të depozitave në usd dhe në euro, si edhe zgjerimi i rrejtësive të bankave të sistemit, kanë kontribuar në qëndrueshmërinë e depozitave në sistem. Kjo situatë e mirë likuiditeti e bankave është pasqyruar edhe në funksionimin normal të sistemeve të pagesave, të operuara dhe të mbikëqyruara nga Banka e Shqipërisë, nëpërmjet të cilave bankat shlyejnë detyrimet e tyre financiare.

### 3.3 RREZIQET E TREGUT

Në lidhje me rreziqet e tregut, analizohet rreziku i kursit të këmbimit dhe ai i normës së interesit, për sa kohë që rreziku i çmimit të kapitaleve dhe ai i "mallrave të tjerë" nuk janë ende të pranishëm në sistemin tonë financiar.

Rregullorja e miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Mbi rreziqet e tregut", i kërkon bankave të nivelit të dytë të përllogarisin kërkesat individuale për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të normës së interesit dhe atij të kursit të këmbimit, çdo gjashtëmuor.

Konkretisht, në fundvit, sistemi bankar evidenton normën e mbulimit prej 145 për qind, e cila tregon raportin midis madhësisë aktuale të kapitalit rregullator të sistemit me madhësinë e kërkuar të kapitalit rregullator, për mbulimin e rreziqeve të tregut.

Gjithashtu, për matjen e ndjeshmërisë së bankave ndaj rreziqeve të tregut përgatiten dhe disa skenarë hipotetikë, sipas të cilëve përllogariten humbjet konkrete, që mund të pësojnë bankat për shkak të luhatjeve të kursit të këmbimit apo të normave të interesit.

Kështu, rreziku i kursit të këmbimit merr në konsideratë ndikimin e nën/mbigjimit të lekut kundrejt dy monedhave kryesore (euro, usd), mbi kapitalin rregullator të bankave individuale dhe të sistemit në tërësi.

Ekzistenca e pozicioneve neto në një monedhë të huaj, ekspozon bankat ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit për atë monedhë. Humbja / fitimi i bankës është pikërisht ky pozicion neto, i shumëzuar me ndryshimin e kursit të këmbimit. Me këtë madhësi ndikohet kapitali i bankës, rrjedhojë e ndryshimit të kursit të këmbimit.

Në lidhje me rrezikun e normës së interesit përgatiten tre teste. Testimi mbi rrezikun e normës së interesit merr në konsideratë ndikimin e ndryshimit të normës aktuale të interesit për monedhat euro, usd dhe lek mbi kapitalin rregullator të bankave dhe të sistemit në tërësi. Kështu, shfrytëzohet norma aktuale e interesit të çdo monedhe dhe llogaritet ndikimi i rritjes/rënies së saj në kapitalin rregullator të bankave, nëpërmjet diferencës së vlerave aktuale të gap-eve në monedhat euro, usd dhe lek për shporta të ndryshme maturimi, sipas normës aktuale të interesit dhe normës së re të saj.

Në mënyrë të përmbledhur, analiza e këtyre skenarëve flet për një sistem bankar minimalisht të ekspozuar ndaj rreziqeve të mundshme.

## 4. MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

### 4.1 KAPITALI AKSIONER

Në fund të vitit 2006 kapitali aksioner i sistemit arriti në rreth 42 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 9.1 miliardë lekësh ose 27.7 për qind, krahasuar me fundvitin 2005. Peshën më të madhe në rritjen e kapitalit aksioner të sistemit e ka mbajtur grupi i bankave të mëdha G3, kapitali aksioner i të cilave është rritur përkatësisht me 6.2 miliardë lekë ose 38.8 për qind. Ndërsa, kapitali aksioner i grupit të bankave të mesme G2 dhe atyre të vogla G1 është rritur përkatësisht me 1.7 miliardë lekë ose 15 për qind; dhe 1.3 miliardë lekë ose 21.4 për qind.

Tabelë 11. Struktura e kapitalit aksioner të sistemit dhe ecuria e komponentëve të tij në vite.

Treguesit	Dhjetor 2004		Dhjetor 2005		Dhjetor 2006	
	në milionë lekë	në %	në milionë lekë	në %	në milionë lekë	në %
Kapitali i vet aksioner	25,949.5	100.0	33,013.8	100.0	42,162	100
Kapitali i paguar <sup>25</sup>	23,593.5	71.5	29,420.3	77.4	34,768	71.5
Primet e aksioneve	1.8	0.0	1.8	0.0	363.5	0.9
Rezervat	2,436.8	9.4	1,432.9	4.3	3,309.4	7.8
Diferenca rivlerësimi	-5,033.8		-3,852.3		-4,611.5	
Fitimi/humbja e pashpërndarë	-155.0		-184.3		1,281	3
Fitimi/humbja e vitit në vazhdim	5,106.1	19.7	6,195.5	18.8	7,051.3	16.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Komponenti, kapital i paguar, ka ulur paksa peshën e tij në kapitalin aksioner të sistemit, në rreth 71.5 për qind, por vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në rritjen e tij edhe gjatë vitit 2006. Rritja e kapitalit të paguar nga 13 banka të sistemit si edhe hyrja e një banke të re në sistem, kanë sjellë

rritjen e kapitalit të paguar në tërësi me rreth 5.3 miliardë lekë ose 18 për qind, krahasuar me fundvitin 2005. Efekti i kapitalit të paguar në kapitalin aksioner të sistemit reduktohet paksa, në qoftë se marrim parasysh diferencat e rivlerësimit, të cilat vazhdojnë të jenë negative, madje edhe janë rritur me rreth 760 milionë lekë këtë vit, si rezultat kryesisht i mbiçmimit të lekut kundrejt dollarit amerikan. Ndikim të konsiderueshëm mbi kapitalin aksioner të sistemit kanë pasur edhe rezervat e sistemit. Në fund të dhjetorit 2006, ato kanë kapur shifrën prej 3.3 miliardë lekësh dhe paraqiten gati 2 herë më të larta se rezervat e fundvitit 2005. Mbi kapitalin aksioner të sistemit ndikoi gjithashtu edhe fitimi i pashpërndarë, i cili është rritur me rreth 1.46 miliardë lekë, krahasuar me një vit më parë.

Totali i aktiveve të financuara nga kapitali aksioner, në fund të vitit 2006 paraqet një rritje të lehtë, 6.75 për qind nga rreth 6.65 për qind në fund të dhjetorit 2005. Për rrjedhojë edhe leva financiare është ulur disi, ndërsa niveli më i lartë i levës financiare dallohet për bankat e grupeve G3 dhe G2, përkatësisht 5 për qind dhe 8 për qind. E kundërta ndodh me bankat e vogla G1, të cilat përgjithësisht nuk janë konkurruese në treg dhe kanë një shtrirje të kufizuar. Këto banka mbështeten më tepër në financimin e aktiveve me anë të fondeve të veta, gjë e cila pasqyrohet edhe në vlerën e lartë të raportit në fjalë në rreth 23.7 për qind.

#### 4.2 MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin, në fund të vitit 2006 paraqitet në nivelin 18.1 për qind, duke shënuar një rënie prej 0.5 pikë përqindjeje krahasuar me fundin e vitit 2005. Ndikimin kryesor në rënie e lehtë të treguesit e jep rritja me ritme paksa më të larta e totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit, të klasifikuara sipas rrezikut (rreth 67 milionë lekë ose 45 për qind) krahasuar me kapitalin rregullator (rreth 11.4 milionë lekë ose 41 për qind).

Bankat e sistemit kanë vijuar të rrisin investimet e tyre gjatë vitit 2006, siç pasqyrohet edhe në të dhënat e tabelës së mëposhtme. Zgjerimi i kredidhënies -aktivitetit më të rrezikshëm të bankave – është pasqyruar në rritjen me rreth 58 miliardë lekë ose 47 për qind të aktiveve me rrezik të lartë si edhe në rritjen me rreth 5.7 miliardë lekë ose 49 për qind të aktiveve me rrezik të mesëm. Treguesi ka ruajtur prirjen rënëse të vërejtur vitet e fundit, që tregon edhe për një administrim më efektiv të burimeve të sistemit.

Tabelë 12. Ecuria e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut të sistemit bankar në vite.

Treguesi (në milionë lekë)	Dhjetor 2004	Dhjetor 2005	Dhjetor 2006
Aktive pa rrezik	271,216.7	292,452.4	340,775
Aktive me rrezik të ulët	71,384.0	71,480.4	79,720
Aktive me rrezik të mesëm	8,892.7	11,759.0	17,499.5
Aktive me rrezik të lartë	70,805.8	122,319.5	180,161.4
Totali i aktiveve & zërave jashtë bilancit të klasifikuara sipas rrezikut <sup>26</sup>	94,800.7	148,757.1	215,775

Burimi: Banka e Shqipërisë.



Vlera e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat individuale, në fund dhjetorit 2006 varion nga 12.4 për qind deri në 166.1 për qind. Gjatë vitit, vlera e tij minimale e kërkuar, prej 12 për qind është shkëlur përkohësisht vetëm në dy raste. Bankat e grupeve G2 dhe G3, të cilat janë më aktive në treg, shfaqin vlera të raportit të mjaftueshmërisë më afër vlerës minimale të kërkuar, përkatësisht në rreth 15.9 për qind dhe 16 për qind. Për bankat e grupit G1, vlera relativisht e lartë e raportit në fjalë, në rreth 41.3 për qind është tregues i kapaciteteve investuese akoma të pashfrytëzuara prej tyre, në kushtet aktuale të kapitalizimit.

Nga një vështrim krahasues me fundvitin 2005, shohim se raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat e grupit G3 është rritur me 1.6 pikë përqindje, rritje kjo e cila është ndikuar kryesisht nga rritja e kapitalit rregullator të grupit. Ndërkohë që, ndryshimet në vlerën e këtij treguesit për dy grupet e tjera G1 dhe G2, janë të lidhura me zhvillimet e ndodhura në sistemin bankar dhe konkretisht, me kalimin në tremujorin e parë të vitit 2006 të një banke nga grupi G1, në atë G2.

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit në %	Sistemi bankar	G1	G2	G3
Dhjetor 2006	18.1	41.3	15.9	16.0
Dhjetor 2005	18.6	35.0	19.4	14.4
Dhjetor 2004	21.6	47.3	17.8	17.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 13. Ecuria e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave.

## 5. TREGUESIT E RENTABILITETIT

### 5.1 REZULTATI NETO DHE STRUKTURA E TIJ

Rezultati neto i sistemit bankar për vitin 2006 raportohet rreth 7.45 miliardë lekë ndaj 6.6 miliardë lekëve, një vit më parë apo 12.9 për qind më shumë. Të ardhurat nga aktivitetet kryesore, të cilat pasqyrohen në të ardhurat neto nga interesi rezultojnë 31.2 për qind më shumë se një vit më parë, duke reflektuar orientimin e aktivitetit të sistemit bankar në aktive me më tepër rrezik dhe si rrjedhojë, edhe kthim më të lartë<sup>27</sup>; ndryshimin e strukturës së maturimit të aktiveve me rrezik të lartë<sup>28</sup>; rritjen e vëllimit të aktiveve në tërësi, në kushtet kur ndryshimi i interesit bazë për të treja monedhat kryesore të bilancit, përgjithësisht pasqyrohet në mënyrë më të favorshme për aktivet sesa për pasivet. Zhvillimet pozitive në treguesin e të ardhurës neto nga interesat pasqyrohen edhe në dinamikën e treguesit të marzhit neto nga interesat, NIM. Gjithashtu, në fund të vitit 2006, e ardhura neto nga interesat ishte 92.6 për qind e të ardhurave bruto të sistemit bankar<sup>29</sup>, krahasuar me 84 për qind në fund të vitit 2005. Ky tregues ka shënuar rritje të vazhdueshme, veçanërisht në tre vitet e fundit, duke shprehur qëndrueshmërinë e të ardhurave neto në tërësi për sistemin bankar.

Sistemi bankar për vitin 2006, pasqyron një rënie të vogël të kthimit nga aktivet mesatare. Kahu i kundërt i lëvizjes së RoAA ndaj treguesit të NIM, dëshmon për një ndikim të shpenzimeve të rritura të veprimtarisë dhe deri-

diku edhe të provigjoneve, në përlogaritjen e të ardhurës neto. Gjykojmë që zhvillimet në shpenzimet e veprimtarisë dhe në provigjone tregojnë përgjithësisht, një rritje të aktivitetit të sistemit bankar dhe përmirësim të ndërmjetësimit.

Sistemi bankar edhe në fund të tremujorit të katërt të vitit 2006 vijon me një performancë, e cila në tërësi shfaqet më e mirë sesa një tremujor më parë, por e krahasueshme për rezultatin nga veprimtaria kryesore. Rezultati neto përlogaritet mbi 23 për qind më i lartë në krahasim me një tremujor më parë si edhe me mesataren tremujore për vitin 2006. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, rritja e rezultatit neto përlogaritet dukshëm më e lartë, rreth 64 për qind. Në performancën më të mirë në vlerë absolute të sistemit bankar në krahasim me të njëjtin tremujor të një viti më parë, ka ndikuar kryesisht rritja e shpejtë e rezultatit neto nga interesat si edhe nga veprimtaritë e tjera.

Tabelë 14. Ecuria e elementeve kryesore të rezultatit neto (jo kumulative) në milionë lekë.

Treguesit	Dhjetor '06	Shtator '06	Dhjetor '05
Rezultati neto nga interesat	5,621.90	5,577.87	4,916.08
Rezultati neto nga veprimtaritë e tjera	1,431.93	1,047.05	1,171.06
Shpenzimet e veprimtarisë	3,599.74	3,529.59	3,093.09
Shpenzime për provigjone	443.83	469.34	555.15
Shpenzime për provigjone për kredi	461.61	549.47	n/a
Rezultati neto (pas tatimit)	2,329.47	1,881.69	1,357.18

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Krahasuar me tremujorin e kaluar, analiza e komponentëve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, tregon për një kontribut thelbësor të rezultatit neto nga veprimtaritë e tjera. Rritja për këtë tregues është rreth 36.8 për qind dhe përfaqëson një kontribut mbi 85 për qind në rritjen e rezultatit neto. Dinamika në treguesin në fjalë ka ardhur kryesisht nga rritja e të ardhurave neto nga komisionet dhe veprimet me valutat, por edhe e të ardhurave të tjera nga veprimtaria bankare. Kontributi i rezultatit neto nga interesat, shpenzimet e veprimtarisë dhe provigjonet ka qenë modest.

Përgjithësisht, këto zhvillime tregojnë për një rritje të vëllimit të aktivitetit të sistemit bankar; për një ecuri të mirë të portofolit të kredive për këtë tremujor, si edhe për një rritje të moderuar të të ardhurave nga veprimtaritë kryesore. Kjo rritje duket të jetë e përcaktuar disi, nga një stabilitet i normave të interesit dhe ndryshime jo të rëndësishme strukturore të bilancit të bankave apo aktiveve kryesore, që gjenerojnë të ardhura.

Performanca e bankave individuale mbi baza kumulative, e matur si numër bankash me rezultat neto negativ edhe për tremujorin e katërt, vazhdon të jetë e njëjtë me atë të tremujorit të kaluar. Evidentohen përsëri gjashtë banka të tilla që i përkasin kryesisht grupit të bankave të vogla. Edhe në terma jokumulative, evidentohen përsëri katër banka me rezultat neto negativ, të cilat i përkasin tërësisht grupit të bankave të vogla.

Bankat që kanë kontribuar më tepër në rezultatin neto të sistemit janë bankat më të mëdha dhe një nga bankat e grupit të mesëm. Kontributin më të madh në rezultatin neto të sistemit, për vitin 2006 si edhe për tremujorin e fundit të tij, vazhdojnë ta japin dy banka të G3 dhe një bankë e G2. Ky kontribut përcaktohet jo vetëm nga madhësia e tyre, por edhe rentabiliteti që i rendit këto banka në vendet e para, në lidhje me madhësinë e kthimit nga aktivet.

## 2.2 TREGUESIT E RENTABILITETIT

Performanca e treguesve kryesorë të rentabilitetit, përkatësisht kthimi nga aktivet mesatare (RoAA) dhe kthimi nga kapitali mesatar (RoAE), ishte mjaft e mirë edhe për vitin 2006. Treguesi i RoAA u luhet nga niveli 1.41 për qind në bazë vjetore për fundin e tremujorit të parë, në 1.24 për qind në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2006, për të shënuar një rritje graduale prej 1.28 për qind dhe 1.36 për qind përkatësisht, në fund të nëntëmujorit dhe të vitit 2006. Lulahshmëria në kohë e treguesit të RoAA për këtë vit, duket të jetë e moderuar dhe tregon për një prirje drejt mesatares tremujore në fund të tij.

Treguesit	Dhjetor '06	Shtator '06	Dhjetor '05
RoAA	1.36	1.28	1.40
RoAE	20.17	19.17	22.24

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 15. Tregues kryesorë të rentabilitetit në përqindje.

Rënia e RoAA me 0.04 për qind në vitin 2006 krahasuar me vitin 2005, shpjegohet me ritmin më të lartë të rritjes së aktiveve mesatare (16.7 për qind), ndaj të ardhurës neto. E kundërta ka ndodhur në tremujorin e fundit të vitit. Rritja e rezultatit neto me burim nga aktivitetet jokryesore ka qenë përcaktuese, duke ndikuar në një rritje të konsiderueshme të RoAA. Edhe për RoAE, rritja më e shpejtë e kapitalit mesatar aksioner gjatë vitit 2006, ndaj të ardhurës neto përbën thelbin e rënies së këtij treguesi. Në ecurinë e këtyre treguesve, ndikon edhe hyrja në treg e bankave të reja, të cilat në fazën fillestare të veprimtarisë së tyre kontribuojnë më tepër në drejtim të rritjes së aktiveve të sistemit dhe më pak, në drejtim të rezultatit të tij financiar. Këta tregues, në kushte të tjera të pandryshueshme, do të performonin edhe më mirë, çka vërtetohet edhe në rastin konkret.

Gjithashtu, nivelet relativisht të larta të kthimit nga kapitali aksioner, nuk evidentojnë ndonjë parashikim të mundshëm për shpërndarje të fitimeve nga aksionerët. Përkundrazi, të ardhurat kanë shërbyer si një mbështetje e mirë e bankave për zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarisë.

Analiza e treguesit të RoAA sipas grupbankave, edhe për fundin e vitit 2006 vijon me rentabilitet më të lartë për bankat e G3, pasuar nga bankat e G2 dhe G1. Treguesi i RoAA për G3 përlllogaritet rreth 1.62 për qind nga 1.72

për qind, ndërsa RoAA për G2 përllogaritet në nivelin 1.03 për qind ndaj 0.72 për qind, në fund të tremujorit të tretë. Në këtë dinamikë konvergjente të RoAA për këto dy grupe, ka ndikuar performanca shumë e mirë e bankave të G2 vetëm për tremujorin e katërt, ku RoAA jokumulative mbi baza vjetore përllogaritet 2.06 për qind<sup>30</sup>. Ndërkohë, bankat e G1 vijojnë me një RoAA negative edhe për fundin e vitit, ndonëse performanca e tyre vetëm për tremujorin e katërt rezulton më e mirë. Bankat e këtij grupi shfaqin një nivel të lartë të shpenzimeve të veprimtarisë ose të krahasueshëm, në raport me rezultatin neto nga veprimtaritë kryesore. Edhe rezultati neto nga veprimtaritë e tjera, i cili rezulton pozitiv, është relativisht i vogël dhe nuk kontribuon në mënyrë të qenësishme për një kthim të krahasueshëm me nivelin mesatar të sistemit bankar. Këto zhvillime, tregojnë për një mungesë efieciencie në një pjesë të mirë të bankave të këtij grupi, bashkëshoqëruar edhe me një vëllim të kufizuar të veprimtarisë bankare.

Rentabiliteti i sistemit bankar nga veprimtaria kryesore si edhe dinamika e ekuilibrit ndërmjet mbledhjes së burimeve, për të cilat paguhet interes dhe investimit në aktive që fitojnë interesa, jepet në dy tabelat në vijim:

Tabelë 16. Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore në përqindje.

Treguesit	Dhjetor '06	Shtator '06	Dhjetor '05
Të ardhura nga interesat/aktive mesatare që sjellin të ardhura (1)	7.05	7.04	6.81
Shpenzime për interesa/aktive mesatare që sjellin të ardhura (2)	2.83	2.76	3.08
Marzhi neto nga interesat (NIM)[(1) – (2)]	4.22	4.27	3.73

Burimi: Banka e Shqipërisë.

